

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I JURIDIKËS  
ПРАВЕНА ФАКУЛТЕТ  
FAKULTY OF LAW

Fakulteti i Juridikës  
Studime pasdiplomike- Studimet e Sigurisë

PUNIM MAGJISTRATURE

**“KARAKTERISTIKAT FENOMENOLOGJIKE DHE ETIOLOGJIKE TË  
VIKTIMAVE TË VEPRAVE PENALE ME THEKS TË VEÇANTË TEK  
VIKTIMAT E VRASJEVE PËR TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE NË  
TETOVË PËR PERIUDHËN 2008-2018”**

**Kandidati:**

Xhemal Jashari

**Mentori:**

Prof.Asoc.Dr.Besa Arifi.

Dhjetor, 2020

## PËRMBAJTJA E PUNIMIT TË DIPLOMËS

FALËNDERIMET .....	4
1. QËLLIMET E HULUMTIMIT .....	6
2. Hipotezat.....	7
3. Rëndësia e punimit.....	8
KAPITULLI I PARË .....	9
1.0 NJOHURITË E PËRGJITHSHME MBI VIKTIMAT .....	9
2.1 Definime dhe përkufizime të nocionit viktimë .....	13
1.2 Përhapja e viktimave.....	16
KAPITULLI I DYTË.....	19
2. FORMAT E VIKTIMAVE NË SHOQËRINË BASHKËKOHORE .....	19
2.1. Viktimat e krimeve të vrasjes .....	20
2.2. Viktimat e dhunës në familje .....	22
2.3. Viktimat e abuzimit të substancave narkotike .....	24
2.4. Viktimat e krimeve kundër njerëzimit, kundër luftës, dhe akteve terroriste .....	25
KAPITULLI I TRETË.....	27
3. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË SHFAQJEN E VIKTIMIZIMIT .....	27
3.1. Faktorët ekonomik .....	28
3.2. Faktorët social .....	29
3.3. Faktorët e jashtëm .....	33
3.4. Faktorët e brendshëm.....	35
KAPITULLI I KATËRT.....	36
4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	36
VIKTIMAT E VRASJEVE NË TERRITORIN E TETOVËS .....	36
4.1 VIKTIMAT E VRASJEVE NË TERRITORIN E TETOVËS .....	37
4.2. Rastet e vrasjeve në Tetovë.....	38
Përfundimi.....	47
Referencat .....	68



**KARAKTERISTIKAT FENOMENOLOGJIKE DHE ETIOLOGJIKE TË  
VIKTIMAVE TË VEPRAVE PENALE ME THEKS TË VEÇANTË TEK  
VIKTIMAT E VRASJEVE PËR TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE NË  
TETOVË PËR PERIU DHËN 2008-2018**

## FALËNDERIMET

Falënderoj të gjithë ata që kontribuan në përfundimin e këtij studimi, veçanërisht Zotin i cili më ka mbrojtur dhe më ka dhënë mundësinë që ta realizoj qëllimin tim. Gjithashtu unë nuk do të kisha patur mundësinë që ta kryej këtë disertacion pa udhëzimet e anëtarëve të komisionit, përkrahjes nga familja ime dhe ndihma që më është ofruar nga të afërmit dhe shoqëria ime.

I jam shumë në borxh prindërve të mi të cilët dhanë mund dhe bënë shumë sakrifica për të arritur këtë sukses. Gjithashtu falënderim i veçantë shkon edhe për kolegët, shoqërinë, emrat e të cilëve nuk do të bëhen publike, por përpjekjet e tyre do të vlerësohen nga unë gjithmonë. I jam gjithashtu mirënjohëse administratave komunale dhe institucioneve publike të cilat aspak nuk hezituan për të më paisur me të dhëna në lidhje me çështjen time.

Përveç kësaj, kompletimi i këtij hulumtimi nuk do të kishte qenë i mundur pa përkrahjen e familjes time:, prindërve të mi, gruas time, si dhe të gjithë anëtarëve tjerë të familjes time. Ndihesha shumë komfort kur e dija se ata do të luteshin dhe do të më përkrahnin mua gjatë gjithë kësaj kohe. Kurajo që ata më jepnin mua kur ndonjëherë gjërat më përkeqësoheshin do të çmohen përgjithmonë nga ana ime.

I jam shumë në borxh për përkrahjen e tyre emocionale, morale, financiare si dhe për dashurinë dhe kujdesin ndaj meje. Ata meritojnë dashurinë e pastër dhe falemenderimin më të thellë.

Dedikuar:  
Familjes

## 1. QËLLIMET E HULUMTIMIT

Një qeverisje e mirë varet prej shumë faktorëve, por në themel të saj qëndrojnë dy kolona mbi të cilat mbështetet demokracia e një shteti, të cilat janë: Të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit.

Viktimat paraqesin pengesë dhe frenim të zhvillimit të sistemit juridik, ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Prandaj, forcimi i shtetit dhe i mekanizmave të saj institucionale është faktor vendimtarë për parandalimin dhe luftimin me sukses të viktimave.

Kriminaliteti si vepër penale në veçanti tek viktimat është e sanksionuar me dispozita të kodeve penale të të gjitha shteteve dhe si dukuri është prezente në çdo fushë të jetës, me theks të veçantë në institucionet publike dhe shtetërore, si në: Administratën publike, sistemin gjyqësor, prokurorial, arsimor, shëndetësor, ekonomik, etj. E tërë kjo zhvillohet në kufijtë e shmangies së ligjit.

Disa nga qëllimet dhe arsyet që më kanë shtyrë të merrem me trajtimin e kësaj teme janë, se:

- *Kjo temë nuk është trajtuar mjaftueshëm d.m.th. jo aq sa kërkon nevoja për forcimin e mëtejshëm të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të zvogëlimit të kësaj dukurie kriminale. Prandaj, për parandalimin dhe luftimin e viktimizimit është mëse e domosdoshme studimi i kësaj dukurie në mënyrë më të gjithanshme;*
- *Në Maqedoninë e Veriut në bazë të të gjeturave të deritanishme, rezulton se çdo ditë e më tepër është në rritje numri i viktimave, të cilat prekin struktura të rangut të ndryshëm të kryesve të kësaj veprë;*
- *Në Republikën e Maqedonisë së Veriut është prezent “numri i errët” dhe “numri i përhimtë” në shkallë të lartë të viktimave;*
- *Përkundër masave preventive dhe represive që janë ndërmarrë në Maqedoni me qëllim të parandalimit të viktimave, ende është i pamjaftueshëm suksesi i arritur në këtë drejtim, etj.*

Pra, mund të themi që qëllimi i këtij punimi është hulumtimi respektivisht njohja, trajtimi dhe analizimi në baza shkencore të dukurisë së viktimave, kompleksitetit të tyre, shtrirja dhe natyra e saj, pasojat dhe shkaqet që ndikojnë në paraqitjen e viktimave në shoqërinë shqiptaro - maqedonase dhe në disa vende të regjionit, reformat dhe masat në fushën e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar që duhet të ndërmerren për parandalimin dhe luftimin e saj.

Pra, mund të themi se qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë trajtimi dhe analizimi në baza shkencore të viktimave si dhe propozimi i masave adekuate preventive dhe represive me qëllim të parandalimit dhe luftimit të

## **2. Hipotezat**

Më qëllim të studimit sa më përmbajtësor dhe analizimit të dukurisë së viktimave dhe veprave penale me theks të veçantë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës, kam ngritur këto hipoteza:

### **Hipoteza e parë**

Format e viktimave në shoqërinë bashkëkohore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

### **Hipoteza e dytë**

Kontrolli i pamjaftueshëm institucional. Konsiderohet se një nga shkaqet e manifestimit të përmasave kaq të mëdha të viktimave në Maqedoninë e Veriut janë pikërisht mekanizmat joefikas të kontrollit institucional.

### **Hipoteza e tretë**

Mosfunksionimi i duhur dhe efikas i sistemit gjyqësor. Kolapsi gjyqësor, mungesa e stafit gjyqësorë, lëndët e grumbulluara, parashkrimi i lëndëve, proceset gjyqësore të tej zgjatura, mungesa e efikasitetit gjyqësor etj., janë disa nga shkaqet që viktimat në Maqedoni janë evidente në shumë segmente të jetës.

Me qëllim të arritjes së rezultateve të dëshirueshme studimore, gjatë trajtimit të kësaj teme do të shtrohen këto pyetje kërkimore:

- Cilat janë faktorët të cilat ndikojnë në paraqitjen e viktimave ?
- Cilat janë format e viktimave në Maqedoninë e Veriut dhe me theks të veçantë tek vrasjet në Tetovë ?
- Cilat janë motivet kryesore të cilat çojnë deri tek vitkimizimi ?
- Cilat janë pasojat e viktimave në shoqërinë tonë ?
- Sa është i zbatueshëm në praktikë legjislativi penal i cili rregullon veprën penale të vrasjeve?
- Cilat janë masat për parandalimi e viktimave ?

### **3. Rëndësia e punimit**

Viktimologjia si dukuri e shoqërisë bashkëkohore, është përhapur me një ritëm të shpejtë edhe në shoqërinë e Maqedonis së Veriut. Prandaj studimi i saj nga këndvështrimi kriminologjik dhe i së drejtës penale padyshim që ka rëndësi të posaçme teorike dhe pragmatike. Rëndësia teorike konsiston në ofrimin e gjetjeve kërkimore-shkencore nga fusha e viktimologjisë si kategori e veçantë e veprave penale në Maqedoninë e Veriut.

Prandaj studimi dhe hulumtimi i viktimologjisë ka rëndësi të veçantë për faktin se kjo dukuri është në rritje e sipër. Viktimizimi është duke u shprehur në forma të ndryshme si: viktima të vrasjeve, fatkeqësive natyrore, vjedhjeve, dhunës, etj. Njëherit vrasjet dhe viktimat si dukuri kanë prekur te gjitha shtresat e shoqërisë, por ajo që është shqetësuese është niveli i lartë i mos risocializimit të viktimave. Prandaj format e ndryshme të parandalimit të saj janë prioritet i shtetit të Maqedonis së Veriut. Parandalimi i viktimave kërkon ndërmarrjen e reformave institucionale me qëllim të risocializimit të viktimave.



## **KAPITULLI I PARË**

### **1.0 NJOHURITË E PËRGJITHSHME MBI VIKTIMAT**

Një nga nevojat më të rëndësishme që viktimologjia kërkon të paktën brenda shkencave kriminale është krijimi i një teorie të përgjithshme që përshkruan dhe shpjegon të gjitha konceptet, teoritë dhe hipotezat që mund të përdoren në këtë sferë shkencore.

Punimi i tanishëm kërkon të prezantojë një teori të tillë, duke përdorur terminologjitë kryesore që formuan literaturën dhe përmbajtjen e viktimologjisë që nga fillimi i shfaqjes së saj që nga mesi i shekullit XX. Disiplina e re e shkencave kriminale që unë argumentoj në këtë artikull ka dalë në dritën e dy qasjeve kriminologjike dhe ligjore.

Puna e teorisë së viktimologjisë është përfshirja e këtyre qasjeve në një fushë të unifikuar studimi, e cila bazohet në tre koncepte kryesore: personaliteti aktiv i viktimës, natyra e viktimizimit / viktimizimit dhe pasiviteti i viktimës.

Në konsideratat e mia përfundimtare, unë përfundoj se teoria e viktimologjisë mund të ketë virtyte dhe përparësi, duke përfshirë edhe etiologjinë penale, duke parandaluar viktimizimin dhe ofendimin, formulimin e përgjithshëm të një politike më të mirë penale dhe një sistem të drejtësisë penale në praktikë.

Sot, viktimologjia si një fushë studimi që lidhet me viktimat e krimit, mund të thuhet, është bërë një degë e shkencave kriminale.

Megjithëse pionierët e kriminologëve janë përpjekur ta konsiderojnë viktimologjinë si një nënfushë të kriminologjisë<sup>1</sup> dhe kjo prirje ka vazhduar ende si sferë shkencore, Fakti tregon se viktimologjia nuk është kufizuar në një kornizë kriminologjike.

Megjithëse trajtimi i nevojave të viktimave gjithnjë e më shumë paraqitet si çështje me rëndësi në drejtësinë tranzicionale, diskutimi serioz kritik mbi ndërtimin politik dhe shoqëror të viktimizimit është duke u zhvilluar vetëm në terren. Në praktikë, viktimat (e çfarëdo lloj krimi) si kategori shpesh përceptohen si pasqyrë e kundërt e shkelësve të ligjit, dhe këto dy kategori, shihen si të ndara në mënyrë mjaft rigjide.

Kjo qasje shkakton mjaft tension mes drejtësisë retributive dhe asaj restorative. Përderisa e para kërkon dënim për një shkelës që thyen ligjin, dhe që ai të vuajë dënimin, akt ky që rjedhimisht do të bënte viktimën/të mbijetuarin të ndihej i kënaqur me verdiktin dhe të gjente prehje, e dyta - drejtësia

---

<sup>1</sup> Bassiouni, M. Cherif [ed.] (1988); International Protection of Victims; Paris, Association Internationale De Droit, érès.

restorative do te merrej kryekëput me riparimin e dinjitetit të viktimës apo të mbijetuarit, dhe rehabilitimin e të njëjtit në shoqëri.

Drejtësia retributive na sugjeron një perspektivë të tillë që na e ngushton nocionin e të drejtave dhe nevojave të viktimave në mënyrë që ato të adresohen e të lidhen me dënimin e shkelësve që thyejnë ligjin; por ajo restorative shikon përtej gjetjes së fakteve dhe dënimeve të atyre që thyejnë ligjin.

Ajo tenton shërimin dhe riparimin e dinjitetit të viktimës, dhe vazhdon të fokusohet në riparimin e marrëdhënieve të dëmtuara si shkak i krimit, gjithmonë duke kërkuar nga shkelësit e ligjit përgjegjësi dhe llogaridhënie.

Nisemi nga fakti që statusi 'i vërtetë' i viktimës kërkon pafajësi. Në veçanti në pikëpyetje vihet nocioni i 'pafajësisë' si parakusht për njohjen e viktimave, si dhe shqyrton mënyrat në të cilat viktimat dhe autorët nuk janë gjithmonë të identifikuar lehtë si kategori të ndryshme në shoqëritë postkonfliktuale ose në ato në tranzicion.

Nga literatura e viktimizimit, dimë se, megjithëse është e nevojshme një njohje më e nuancuar shkencore rreth nevojave të viktimave, megjithatë, kjo njohuri në mënyrë të pashmangshme është ndërtuar si koncept social dhe politik, shih për këtë krijon një platformë për interpretime të ndryshme.

Gjithashtu supozohet se në të shumtën e rasteve format e pretendimeve politike që lidhen me nevojat dhe të drejtat e viktimave të krimit, mund të jenë të lidhura në mënyrë të kundërt me respektin për nevojat dhe të drejtat e shkelësve të ligjit.<sup>2</sup>

Meqenëse shumica e përfaqësimeve të viktimave duket se nxjerrin në pah disa vlera dhe përvoja mbi të tjerët, ato në mënyrë të pashmangshme përfshijnë pasoja paradoksale. Nga njëra anë, ndërtimi i viktimizimit përfshin një akt humanizimi: Kur tregohen historitë e viktimave, viktimat bëhen diçka më shumë se një numër. Përmes përfshirjes së tyre në një kolektiv, përvojat e tyre jepen me vlerë dhe kuptim.

Nga ana tjetër, përfshirja e disave nënkupton përjashtimin e të tjerëve, të cilëve u mohohet vlera dhe kuptimi i imputuar. Sociologu John Mack e ka quajtur këtë proces të përjashtimit "egoizëm të viktimizimit:" "paafësia e një grupi etno-kombëtar, është rezultat i drejtpërdrejt i traumave të veta historike, për t'u bashkëndjerë me vuajtjet e një grupi tjetër " (1990: 125).<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> Victimology in transitional justice: Victimhood, innocence and hierarchy, Kieran McEvoy Queens University Belfast, UK; Kirsten McConnachie, University of Edinburgh, UK, European Journal of Criminology 9(5) 527-538, 2012.

<sup>3</sup> victimhood, Identity, and Agency in the Early Phase of the Troubles in the Northern Ireland, Sissel Rosland, Identities, 16:3, 294-320,

Kjo lloj 'paaftësie' nuk na është shfaqë shpesh në terren gjatë punës me viktimat dhe të mbijetuarit e luftës në RMV. Përkundrazi ka qenë kjo kategori e prekur nga lufta, e cila ka shprehë një dozë të madhe të empatisë dhe solidarizimit me vuajtjet dhe sakrificën e viktimave të etnive tjera, me fjalë tjera e njëjta vazhdon të bashkëndejë vuajtjet e të mbijetuarve të etnive tjera. Janë të paprekurit nga lufta, ata që vazhdojnë të manipulojnë lirshëm dhe pa respekt me këtë kategori dhe në emër të kësaj kategorie, si dhe kërkojnë llogaridhënie nga shkelësit e ligjit. Vija e cila përcakton limitet e vuajtjeve dhe tronditjen që ka pësuar viktimat apo i mbijetuari është vështirë të përcaktohet, ngase viktimizimi si proces mund të jetë fluid.

Një hierarki e viktimizimit, e bazuar në dallimet ndërmjet asaj që Madlingozi (2007) i ka quajtur viktimat "të mira" dhe viktimat "të këqija", shpeshherë flet mbi pikëpamjet subjektive mbi 'justifikueshmërinë' e vuajtjeve që analizohen tek viktimat dhe të mbijetuarit e luftës, si dhe taktikat dhe qëndrimet e këtyre kategorive për t'u marrë me të kaluarën.<sup>4</sup>

Ky kryqëzim midis pafajësisë dhe fajit paraqet vështirësi të mëdha për drejtësinë tranzicionale, veçanërisht aty ku viktimat mund të kenë kryer edhe vetë abuzime të të drejtave të njeriut. Siç vë në dukje Claire Moon (2009: 101), Komisioni i të Vërtetës dhe Pajtimit të Afrikës së Jugut kërkoj që afrikano-jugorët të caktoheshin si "viktimat" ose "autorët", dhe të ekzistonte një prerje kategorike mes këtyre dy grupacioneve. Kjo përjashtonte 'disa të tjerë' që nuk mund të strehoheshin lehtë brenda këtyre dy kategorive (shih gjithashtu Borer, 2003).

Ne argumentojmë se dihotomia mes viktimës dhe shkelësve të ligjit si në rastin me **fëmijët ushtarë** duhet të rishqyrtohet, dhe se kjo mund të bëhet me sukses vetëm përmes një qasjeje vërtet interdisiplinare, dhe assesi të shihet nga një kënd njëdimensional.

Një figurë e diskutueshme si Robert McBride, të cilit iu dha amnisti për veprimet e tij gjatë luftës çlirimtare në Afrikën e Jugut (i cili ishte përfshirë në hedhjen e një bombe në një pub, që shkaktoi vdekjen e tre personave dhe plagosi 69 civilë të tjerë), kishte deklaruar se edhe ai kishte qenë viktimë e regjimit të apartheidit dhe se ishte vendosmëria e tij për të luftuar kundër atij sistemi që çoi në përfshirjen e tij në vrasjen e civilëve dhe luftën e armatosur (Du Bois-Pendain, 2007: 213).

Divergjencia e këtyre pikëpamjeve flet direkt për një problem qendror. Qeniet njerëzore mund të lëvizin mes mirëdashjes dhe ligësisë në një ditë të vetme, dhe kurrë nuk e mendojnë gjatë gjithë jetës se kanë jetuar në një shoqëri që përjetoi dhunë politike ose etnike.

---

<sup>4</sup> Victimology in transitional justice: Victimhood, innocence and hierarchy, Kieran McEvoy Queens University Belfast, UK; Kirsten McConnachie, University of Edinburgh, UK, European Journal of Criminology 9(5) 527-538, 2012.

Pikërisht për këtë, rritet potenciali për ndjeshmëri njerëzore si për viktimat ashtu edhe për shkelësit e ligjit. Dhe ndërsa të parët nuk janë të paqortueshëm, këta të dytët kanë kryer veprime të tmerrshme.<sup>5</sup>

Nuk duhet të harrojmë se shkelësit e ligjit, viktimat por dhe dëshmitarët hezitues formojnë së bashku një marëdhënie komplekse dhe shumë emocionale, të lidhur me sekretet dhe heshtjen që mbajnë. Këto kategori e njohin shumë mirë njëra tjetrën dhe luajnë rol qendror në jetën e njëri tjetrit. Shkëputja e marëdhënieve të tyre që bëhet përmes dëmit të shkaktuar, është po aq e dhimbshme sa vetë dëmi që u është bërë, dhe do të jetë shumë e vështirë për t'u riparuar.

Hedhja dritë mbi këtë marëdhënie të ndërlikuar dhe të ngarkuar është detyrë dhe përgjegjësi e studiuesve që në të ardhmen këtë marëdhënie komplekse mes këtyre kategorive ta zbërthejnë më tutje.

---

<sup>5</sup> Victimology in transitional justice: Victimhood, innocence and hierarchy, Kieran McEvoy Queens University Belfast, UK; Kirsten McConnachie, University of Edinburgh, UK, European Journal of Criminology 9(5) 527-538, 2012.

## 2.1 Definime dhe përkufizime të nocionit viktimë

Nocioni i viktimës në teorinë e viktimologjisë është një koncept me në qendër personin i cili përcaktohet duke u bazuar në personalitetin e viktimës. Përkufizimi duhet të hartohet në një mënyrë të tillë që të mbulojë të gjitha format e viktimizimit / viktimizimit që rrjedhin nga sjellja kriminale dhe sjelljet e tjera të cilat mund të kriminalizohen edhe pse në nivelin ndërkombëtar.<sup>6</sup>

Përderisa në gjithë botën interesimi për krimin, kryesin ka qenë shumë i hershëm, duke i trajtuar gjerësisht në teori, duke nxjerrë ligje, interesimi dhe trajtimi i viktimës së krimit është relativisht i ri. Në shumë vende që janë me të avancuara sa i përket mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi, gjithashtu ka edhe një orientim serioz dhe qasje praktike për trajtim adekuat dhe dinjitoz të personave që kanë pësuar nga krimi në çfarëdo forme.

Për këtë janë nxjerrë edhe shumë konventa, rregullore, rekomandime, deklarata, ligje për të garantuar mbrojtje nga aspekti juridik dhe janë ngritur institucione të posaçme me qëllim sigurimin e një sistemi sa më të fuqishëm të drejtësisë për mbrojtjen e pozitës së viktimës së krimit. Megjithëse ka një përparim sa i përket të drejtave të viktimës së krimit, ende nuk ka barazi në raport me kryesin në rrafshin e trajtimit juridik të pozicioneve të tyre si subjekte të aktit kriminal.<sup>7</sup>

Tashmë dihet se ka një numër të konsiderueshëm të OJQ-ve, asociacioneve, qendrave strehimore-rehabilituese dhe grupeve të tjera që ofrojnë ndihmë në forma të ndryshme për palët e dëmtuara nga aktiviteti kriminal. Ky kontribut i tyre është shumë i madh dhe i nevojshëm, madje në disa raste këto grupe janë mbështetja e vetme për viktimat e krimit, sidomos pas përfundimit të procedurës gjyqësore në lidhje me rastin penal.

Mirëpo sadoqë puna e tyre është e dobishme ato nuk udhëheqin procesin gjyqësor dhe nuk kanë kompetencë për nxjerrjen e normave juridike detyruese për garantimin e të drejtave të personave që pësojnë nga krimi. Andaj nga ky aspekt, roli i institucioneve shtetërore është i pazëvendësueshëm, për arsye se rregullimi juridik i të drejtave të viktimës i mundëson asaj qasje të efektshme në procedurë dhe realizim të interesave, në anën tjetër krijohen kushte edhe për mekanizmat joqeveritarë që të ofrojnë shërbime alternative për viktimat.

Kjo njëherësh është në frymën e rekomandimeve kryesore të akteve ndërkombëtare që i dedikohen përmirësimit të pozitës së viktimës.

---

<sup>6</sup> Bassiouni, M.C., (2006), "International Recognition of Victims' Rights", Human Rights Law Review 6: 2.

<sup>7</sup> Hallevey, Gabriel, (2010), A Modern Treatise on the Principle of Legality in Criminal Law, Springer.

Duhet theksuar se iniciativat për mbrojtjen e viktimave të krimit dhe realizimin e të drejtave të tyre janë të mirëseardhura nga të gjithë, mirëpo iniciativa e institucioneve ligjvënëse për nxjerrjen e normave juridike në këtë drejtim ka një rëndësi të posaçme. Sepse një mbrojtje adekuate e viktimës së krimit në rend të parë nënkupton një përcaktim të saktë të të drejtave të saj me akte juridike, në mënyrë që e gjithë ndihma që i ofrohet viktimës së krimit të burojë nga të drejtat e saj ligjore.

Në krahasim me trajtimin e kryesit të krimit, trajtimi i viktimës është shumë i ri. Sigurisht se edhe në të kaluarën, viktima e krimit ka qenë e njohur si nocion, si subjekt i aktit kriminal por nuk është marrë në konsideratë nevoja e saj për një mbrojtje apo kompensim të domosdoshëm.

Pozita e vështirë e viktimës së krimit është e njohur qysh nga sistemet e hershme të drejtësisë. Kodi i Hamurabit në shekullin e tetëmbëdhjetë (p.K) parashihte se viktimat e grabitjeve në rrugë duhet të zhdëmtohen për humbjet e tyre nga thesari i kryetarit<sup>8</sup>.

Mirëpo edhe në këtë kohë edhe shumë e shumë kohë më vonë pozita e viktimës nuk është përmirësuar sa duhet. Në aspektin historik vërehet përpjekja e autorëve të ndryshëm për të kontribuar, për të vënë në pah domosdoshmërinë e njohjes me nevojat e viktimës që ka pësuar nga krimi, për ta njohur raportin e saj me kryesin dhe nevojën për mbrojtje.

Në mesin e autorëve që njihen edhe si pionierë të shkencës së viktimologjisë dallohet kontributi i Hans V. Hentingut i cili në vitin 1948 boton librin e tij “Krimi dhe viktima e tij”. Në këtë libër ai thekson se krimi në pjesën më të madhe dëmton dikë. Andaj mendon se në kuadër të mënjanimin të kriminalitetit kundër shtetit, rendit, shëndetit dhe të tjerave duhet të kihet parasysh se gjithmonë janë dy pjesëmarrës, autori i krimit dhe viktima.<sup>9</sup>

Në kohën me të re, përkatësisht në kah fundi i viteve 1970 dhe fillimi i viteve 1980, në shumë vende, është bërë një ngritje e përgjithshme e vetëdijes mbi nevojën e përqendrimit të vëmendjes në viktimat e krimit dhe për të siguruar një sistem të gjithanshëm të drejtësisë.<sup>10</sup> Mund të themi se pozita e viktimës së krimit historikisht ka ndryshuar shumë.

Nga pozita kur të drejtat e saj nuk janë mbrojtur me ligj, vetëm është njohur si subjekt i krimit dhe është shfrytëzuar si burim provash, deri sa tani të drejtat e saj janë njehsuar plotësisht me të drejtat e njeriut në tërësi.

---

<sup>8</sup> Adler, Freda dhe të tjerë: Criminology, New York, 1995, fq. 397.

<sup>9</sup> Henting, Hans Von: The criminal and his victim, Archon Books, 1967, fq. 383.

<sup>10</sup> Udhëzues për mbrojtjen e viktimave-Si të punohet me viktimat e krimit, OSCE, Misioni në Kosovë, Prishtinë, 2001, fq. 44 (më tutje i referohemi si Udhëzuesi).

Në funksion të kësaj janë miratuar dhe fuqizuar shumë akte juridike. Por, prapë mbetet shumë aktuale nevoja për të përmirësuar statusin juridik të viktimave të krimit sidomos ne vendet që nuk kanë bërë sa duhet në këtë drejtim.

## 1.2 Përhapja e viktimave

Përhapja e viktimave, viktimat mund të jenë të llojeve të ndryshme, d.m.th kemi viktima të dhunës fizike, të dhunës gjinore, viktima të trafikimit të fëmijëve. Në këtë nënkapitull do të flasim vecanërisht për secilën.

Studimi mbi përmasat e formave të ndryshme të dhunës seksuale përqendrohet në gjendjet me dhunë seksuale në Republikën e Maqedonisë. Domethënë, qëllimi është për të marrë një pasqyrë për njohjen e formave të ndryshme të dhunës seksuale në mesin e popullatës së përgjithshme, si dhe kuptimet, perceptimet dhe stereotipat e publikut në lidhje me arsyet e paraqitjes së këtij fenomeni negativ.

Me këtë hulumtim parashihet të përcaktohen përvojat, qëndrimet dhe besimet e njerëzve lidhur me format më të zakonshme të dhunës seksuale në Maqedoni dhe shkallën e raportimit. Termi dhunë seksuale është një term i përgjithshëm që përdoret për të treguar disa lloje të ndryshme të agresionit, që kanë lidhje me seksualitetin duke filluar nga përdhunimi, që mund ta kryejë një person të huaj, një grup të tërë, një person të njohur, një anëtar të familjes, deri tek “lajkatimi” i padëshiruar dhe shakat e padëshiruara me konotacion seksual.

E zakonshme për këto forma të dhunës është se seksi dhe seksualiteti janë përdorur si një instrument për të shprehur forcën, ose fuqinë mbi viktimën, duke shkaktuar dhimbje psikologjike (poshtërim, frikësim, turp, etj) dhe, në disa raste, lëndim fizik (nga lëndimet e vogla dhe e përkohshme deri në vdekje) ose dëm (infeksione seksualisht të transmetueshme).<sup>11</sup>

Dhuna seksuale është një çështje që diskutohet rrallë në vendin tonë. Injorimi i dukurisë së dhunës seksuale nuk e zvogëlon seriozitetin e problemit, as nuk e redukton dhimbjen e grave dhe vajzave që kanë qenë viktima.

Duke injoruar problemin, shteti injoron dhe minimizon ndjenjat dhe përvojat e viktimave, integriteti i të cilëve është dëmtuar. Gratë përbëjnë 51% e viktimave të tregtisë me njerëz të zbuluara në nivel global. Gratë dhe vajzat së bashku përbëjnë 71%. Pothuajse 3 nga çdo 4 viktimat e tregtisë me fëmijët janë vajza. Pothuajse 3 nga çdo 4 viktimat e tregtisë me gratë dhe vajzat janë tregtuar për eksploatim<sup>12</sup> seksual. Çdokush mund të jetë një viktimë e dhunës, pavarësisht nga seksi, gjinia, mosha,

---

<sup>11</sup> Kening.N., 2011, Perspektiva gjinore

<sup>12</sup> UNODC (2016). Global Report on Trafficking in Persons 2016, p. 7, 28



përkatësia kombëtare, fetare, etnike, orientimi seksual, statusi i partneritetit, profesioni dhe gjëra të tjera të panumërta me të cilat individit identifikohet.

Kur është në pyetje dhuna seksuale, ka grupe njerëzish më të nënshtruara dhe më të rrezikuara, dhe këto janë: gratë dhe vajzat; fëmijët; personat me aftësi të kufizuara; punëtorët e seksit; Komuniteti LGBT; njerëz të vendosur në institucione psikiatrike, shtëpi për strehim dhe burgjet. Përveç dhunës gjinore si përmendëm më lartë kemi edhe dhunë e fëmijëve. Viktima paraqet çdo person fizik, i cili ka pësuar ndonjë ligësi, përfshirë edhe çrregullim psikik dhe mendor, vuajtje emocionale ose humbje parash, të shkaktuara nga kryerja ose moskryerja (lëshimi), me çka shkelet ligji juridiko-penal i shtetit anëtar.

Aty ku është e mundshme, termi viktimë i përfshin, edhe anëtarët më të ngushtë të familjes së viktimës, të cilët janë në varësi nga viktimi në fjalë. Nocioni “viktimë” në legjislacionin penal të shtetit është definuar disa herë edhe atë në këta mënyra:<sup>13</sup>

Fëmijë-viktimë është çdo fëmijë deri në moshën 18 vjeçare, i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtim fizik dhe mendor, vuajtje motive, humbje materiale, gjegjësisht dëmtim ose kanosje tjetër të të drejtave dhe interesave si pasojë e veprimit të kryer, i cili me ligj trajtohet si vepër penale.

Sipas Kodit Penal:<sup>14</sup> Me nocionin viktimë të veprës penale nënkuptohet çdo person, i cili ka pësuar dëm, përfshirë dëmtim fizik dhe mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose dëmtim dhe kanosje tjetër të të drejtave dhe lirive themelore të tij si pasojë e kryerjes së veprës penale. Me nocionin fëmijë viktimë të veprës penale nënkuptohet personi i mitur deri në 18 vjeç. Viktima e veprës penale është çdo person, i cili ka përjetuar dëm, përfshirë dëmtim fizik dhe mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale, dëmtim ose kanosje tjetër të të drejtave dhe interesave të tij si pasojë e kryerjes së veprës penale.<sup>15</sup>

Viktima e veprës penale i ka të drejtat në vijim:

- 1) Të marrë pjesë në procedurë penale si i dëmtuar me përfshirje në ndjekje penale ose për mënjanimin e kërkesës për dëmin juridiko-pronësor;
- 2) Në kujdes dhe vëmendje të veçantë nga ana e organeve dhe subjekteve të cilët marrin pjesë në procedurën penale dhe

<sup>13</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec (2006) 8 Komiteti i ministrave të vendeve anëtare për ndihmë të viktimave të krim

<sup>14</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 139/2008, në dispozicion në:  
[http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/default\\_mak.asp](http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/default_mak.asp)

<sup>15</sup> ЗАКОН ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА Службен весник на РМ, бр. 150 од 18.11.2010 година

3) Ndhimë efikase psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga ana e organeve, institucioneve dhe organizatave për ndihmë viktimave për vepra penale.

Policia, prokurori publik dhe gjykata veprojnë me kujdes të veçantë ndaj viktimave të veprave penale, duke u dhënë këshilla nga paragrafi (1) të këtij neni dhe nenet 54 dhe 55 të këtij ligji dhe kujdeset për interesat e tyre gjatë miratimit të vendimeve për ndjekje penale kundër të akuzuarit, përkatësisht gjatë marrjes së veprimeve në procedurën penale në të cilën viktimat doemos duhet personalisht të marrë pjesë, për çfarë hartohet një shënim zyrtar ose procesverbal.<sup>16</sup>

---

<sup>16</sup> ЗАКОН ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА Службен весник на РМ, бр. 150 од 18.11.2010 година

## KAPITULLI I DYTË

### 2. FORMAT E VIKTIMAVE NË SHOQËRINË BASHKËKOHORE

Viktimologjia - studimi i viktimave të krimit - u shfaq në vitet 1940 dhe tani është një ndërmarrje disiplinore e kontestuar.<sup>17</sup> Për disa është një disiplinë akademike e vendosur, ndërsa të paktën, një nën-disiplinë e rëndësishme dhe thelbësore e kriminologjisë për të tjerët.<sup>18</sup> Pa dyshim që ka sot ngjashmëri të habitshme midis viktimologjisë dhe kriminologjisë.<sup>19</sup> Sigurisht që debatet për nevojat dhe të drejtat e viktimave tani janë thelbësore për politikën dhe praktikën përreth krimit dhe kontrollit të tij si pasojë e kontributit të dhënë nga viktimologjia dhe viktimologët. Në shoqërinë bashkëkohore kemi disa lloje të krimeve: krimet e vrasjes krimet e dhunës në familje, viktimat e abuzimit të substancave narkotike, viktimat e krimeve kundër njerëimit, kundër luftës dhe akteve terroriste.

---

<sup>17</sup> Maguire, M. (2012) 'Criminal statistics and the construction of crime', in M. Maguire, R. Morgan and R. Reiner (eds), *The Oxford Handbook of Criminology* (5th edn). Oxford: Clarendon Press.

<sup>18</sup> Greer, C. (2013) 'Crime and media: understanding the connections', in C. Hale, K. Hayward, A. Wahidin and E. Wincup (eds), *Criminology* (3rd edn). London: Oxford University Press. fq.143–63

<sup>19</sup> Po aty

## 2.1. Viktimat e krimeve të vrasjes

Qëllimi kryesor i hulumtimit të të vrarit është, pra padyshim zbulimi i kryerësit dhe dënimi tij, po përsëri nga kjo rrjedhë edhe qëllimi tjetër ku me dënim e autorëve të krimeve të vrasjeve arrihet edhe qëllimi i parandalimit të vrasjeve tjera në përgjithësi. Autori i njohur Falandysi thekson se krimi vrasjeve dhe viktimat e tij më së miri janë zbardhur në kërkimet viktimologjike.<sup>20</sup>

Edhe ky është një kërkim shkencor viktimologjik, ku behet studimi i të vrarit. Siç e dimë i vrari është “produkt” i vrasjes, dhe nga personaliteti i të vrarit, ne mundë të kuptojmë sidomos motivet e vrasjes, kapjen e autorëve dhe përcaktimin e sanksioneve.

Gjithashtu do të kemi edhe një pasqyrë më të mirë për moshën e viktimave, gjininë, raportin në mes viktimës dhe kryerësit, mjetet e përdorura gjatë viktimizimit, vendin e viktimizimit si dhe kohën e viktimizimit. Këto janë të gjitha karakteristika të viktimave të vrasjeve në Kosove, që janë hulumtuar në këtë punim masteri.

Sipas organizatë botërore të shëndetësisë, me seli qendrore në Shtetet e Bashkuar të Amerikës dhuna është “ Përdorimi i qëllimshëm ose kërcënim i për mes forcës fizike apo pushtetit, kundër vetës, kundër një personi tjetër apo kundër një grupi apo komuniteti, të një mundësie tjetër, përmes provokimit, të një plagosje, vdekje, një dëmi apo privimi psikologjik.”<sup>21</sup>

Nga kjo nënkuptojmë se çdo forcë fizike që përdoret në mënyra të ndryshme dhe me mjete të ndryshme kundër çdo kujt, pra edhe kundër vetes quhet dhunë. Dhuna si veprim kriminal dhe si pasojë veçohet me disa tipare si p.sh.: Me veprime agresiv, me detyrim të viktimës që të veprojë kundër vullnetit të lirë, me atakim dhe rrezikim të jetës, të shëndetit, të lirisë dhe të mirave tjera të viktimës<sup>4</sup>. Dhuna qenka përdorim i forcës së njeriut kundër njeriut apo grupit të caktuar të njerëzve me qëllim shkaktimin e dhembjes fizike, psikike e morale.<sup>22</sup>

Me viktimë të vrasjeve nënkuptojmë marrjen e jetës së njeriut me mënyra të dhunshme, me metoda dhe mjete të ndryshme. Viktimat e vrasjeve, nga vet nocioni mundë të nënkuptojmë se viktimat shkaktohet nga vrasja.

Vrasjet janë njëri nga shkaqet e vdekjes që shkaktohet në mënyrë të dhunshme.

---

<sup>20</sup> Pr. Dr. Ragip Halili “Viktimologjia” 2007, fq.63

<sup>21</sup> Po aty

<sup>22</sup> Po aty

Vdekja e dhunshme (mors violent) është shuarja me dhunë e jetës. Shkaqet e vdekjes së dhunshme mund të jenë:

1. Mekanike,
2. asfiktisive-për shkak të pengesave në frymëmarrje,
3. Nutritive-për shkak të mungesës së ushqimit,
4. Fizike-për shkak të veprimit të nxehtit e të ftohtit, ndikimit të diellit e të rrymës, rrezeve rëntgenit dhe radiumit,
5. Kimike- kryesisht ndikimi i helmeve,
6. Bakteriale,
7. Psikike.<sup>23</sup>

Ka mënyra dhe metoda të shumtat marrjes e jetës. Studimi i këtyre mjeteve dhe metodave bëhet për arseje që sa më shumë të kemi parandalime të marrjes së jetës në mënyrë të kundërligjshme. Sot në botën bashkëkohore kemi vrasje nga më të ndryshmet dhe sa vjen e shtohen mënyrat dhe metodat e vrasjeve. E tëra në fund mundë të konkluzojm se viktimat e krimeve të vrasjeve janë “produkt” të vrasjeve që ndodhin në botën bashkëkohore.

---

<sup>23</sup> Doc.dr.sc. Nedžad Korajlić, "Deliktet e gjakut, sekeuale, pasurore" Sarajev/Prishtinë, 2007, fq.34

## 2.2. Viktimat e dhunës në familje

Ekzistojnë disa mite e keqkuptime të zakonshme tek popullata në lidhje me dhunën në familje, sidomos për gratë dhe komunitetet e ndryshme, ndërsa mbulimi medial mundet shpesh të mbështesë dhe të nxisë disa prej këtyre miteve. Mitet e zakonshme janë, por nuk kufizohen vetëm në këto:<sup>24</sup>

Dhuna në familje është pasojë e abuzimit të substancave, stresit, varfërisë, dështimit në martesë.

- Kjo është e pasaktë: pasi që nënkupton që ata që përjetojnë ndonjëherë nga ato që u përmenden më lart ushtrojnë dhunë në familje, gjë që përforcon stereotipat negativë. Për më tepër, kjo i jep arsytim keqtrajtuesve, që ushtrojnë dhunë në familje qëllimisht duke përdorur pushtetin dhe kontrollin. Dhuna që ndodh brenda shtëpisë shpesh konsiderohet si çështje private dhe është më pak serioze sesa dhuna që ndodh në publik.

- Kjo është e pasaktë: dhunë në shtëpi është së paku po aq, në mos edhe më shumë, serioze dhe dëmtuese sa format tjera të dhunës, dhe prapë është vepër penale. Dhuna në familje shkaktohet nga problemet me menaxhimin e zemërimit.

- Kjo është e pasaktë: Dhuna në familje përdoret nga ai/ajo që ka kontroll mbi zemërimin e vet, si dhe përdor një sjellje të caktuar për të shtrirë pushtetin mbi tjetrin, pra është vendim i vetëdijshëm që merret nga vetë keqtrajtuesi. Dhuna në familje është pasojë e problemeve në marrëdhënie/familje.

- Kjo është e pasaktë: Ky mit e trivializon (nënvlerëson) dhunën në familje si dhe nënkupton që edhe viktimat ka pasur faj. Gazetarët duhet ta bëjnë të qartë që kryesi nuk mund të arsyetohet në veprimet e tij dhe duhet të nënvizojnë që përgjegjësia është vetëm e kryerësit. Vendimi për të mos e braktisur kryesin shpesh konsiderohet zgjedhje e menduar dhe strategjike e viktimës.

Ikja nga ai mjedis mund të sjellë edhe rritje të rrezikut të sulmeve e kërcënimeve të tjera. Vënia e fokusit tek pyetja pse viktimat nuk ka ikur është fajësim i viktimës, si dhe e heq përqendrimin nga veprimet e keqtrajtuesit.<sup>25</sup> Dhuna në familje nuk është e kufizuar vetëm në keqtrajtim fizik dhe viktimat mund të pësojnë trauma mendore dhe emocionale.

Dhuna në familje ndodh në kontekst familjar dhe pasojat negative zakonisht prekin fëmijët, edhe nëse ata në të vërtetë nuk janë dëshmitarë të dhunës. Fëmijët viktimat të dhunës në familjes janë më të rrezikuar nga zhvillimi i problemeve serioze emocionale, të sjelljes dhe të zhvillimit të mëtutjeshëm.

---

<sup>24</sup> Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 nga Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas (1992) si dhe Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj grave (1993): <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm>

<sup>25</sup> Komiteti CAT, Komenti i përgjithshëm Nr. 3: [https://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/gc/cat-c-gc-3\\_en.pdf](https://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/gc/cat-c-gc-3_en.pdf)

Viktimat e krimeve gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë të identitetit të tyre për arsye të sigurisë dhe privatësisë<sup>26</sup> dhe informata duhet të publikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, si interesi publik. Kjo është tepër e rëndësishme në rastet e dhunës në familje, kur viktimat potencialisht mund të pësojnë pasoja të rënda dhe potencialisht fatale nëse zbulohet identiteti i tyre.

Gjatë raportimit, gazetarët duhet të sigurohen që siguria e viktimës të jetë një nga shqetësimet e tyre parësore dhe gjithnjë duhet të marrin parasysh pasojat e mundshme të dëmshme kur identifikojnë personat në rastet e dhunës në familje.

- Identiteti i viktimës nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare nuk duhet të publikohet asnjëherë në asnjë rrethanë dhe ky kufizim vlen gjithashtu edhe për dëshmitarët dhe të pandehurit.<sup>27</sup>
- Identiteti i viktimës së përdhunimit nuk duhet të publikohet asnjëherë.
- Fotografitë e trupave të të vdekurve nuk duhet të publikohen asnjëherë.<sup>28</sup>

---

<sup>26</sup> 8 Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, neni 8: [http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf)

<sup>27</sup> Konventa për mbrojtjen e personave lidhur me përpunimin automatik të dhënave personale, 108/GDPR, neni 9: <https://rm.coe.int/1680078b37>

<sup>28</sup> R (Press Association) kundër Cambridge Crown Court [2012] EWCA Crim 2434, [2013] 1 WLR 1979, paragrafët 15-17

### 2.3. Viktimat e abuzimit të substancave narkotike

Dëshira për të shkruar një temë për alkoolin dhe substancat narkotike më lindi pikërisht nga kjo përvojë... Kam përpara syve një numër të madh personash të vërtetë, personazhe realë, aktorë të dramës së tyre. I droguari ka të drejtë të marrë disa njohuri për çfarë po i ndodh atij vetë, ndoshta leximi i kësaj teme do ta ndihmojë.<sup>29</sup>Familjari i tij është i pranishëm në këtë tragjedi. Ndoshta edhe ai do të ndihmohet. Politikani dhe personi publik ka përgjegjësinë që të bëjë ligje dhe t'i zbatoj ato. Ndoshta kjo temë do të ndikojë sado pak që edhe politika shurdhe shqiptare të zgjohet më në fund e të fillojë të mendojë për njerëzit, të merret seriozisht edhe me këtë plagë të shoqërisë.

Duke parë dinamikën e përhapjes së një dukurie kriminale mjaft të dëmshme e cila quhet "Alkool" dhe substancave tjera narkotike, problematikat që sollën këto fenomene jo vetëm në aspektin mjekësor e social por edhe në aspektin juridik kanë bërë që të tërhiqet vëmendja edhe e juristëve dhe të opinionit për të luftuar dhe parandaluar ato në të gjitha format e mundshme, në mënyrë të organizuar.<sup>30</sup>

Njerëzit që abuzojnë me alkoolin dhe substancat tjera narkotike përveçse dëmtonin rëndë shëndetin e tyre shëndrroheshin në persona asocial, duke qenë kontigjenti shoqëror më i prirur për të kryer krime të ndryshme. Përzgjedhja e kësaj teme ka marrë sygjerim nga problematika juridiko-penale dhe problemet e shumta që dolën si shkak i këtij fenomeni. Kapitulli trajton problematika të shumta të shkruara p.sh. nga motivet nxitëse për të filluar me substancat narkotike, fillimi i përdorimit të tyre, varësia nga substancat psikotrope, kriza e mungesës dhe shkallëzimi, e deri te viktimat e abuzimit me substancat narkotike dhe raporti i narkomanisë me kriminalitetin midis të cilave një vend të rëndësishëm zë edhe importimi me tregëtim, eksportimi i substancave si dhe trajtimi, terapitë e ndryshme dhe parandalimi i këtyre fenomeneve. Narkokriminaliteti paraqet një dukuri të jashtëligjshme dhe të rrezikshme mjaft të përhapur në mbarë rruzullin tokësor. Prodhimi dhe trafikimi i drogave, së bashku me trafikimin e qenieve njerëzore, me kontrabandën, me krimin ekonomik dhe me pastrimin e parave, është bërë sot një nga aktivitetet ilegale më fitimprurëse të krimit të organizuar.

Përdorimi i narkotikëve dhe i substancave psikotrope po u sjellin mjaft dëme shoqërisë, në përgjithësi e, në veçanti, moshave të reja. Aspekti kriminologjik i narkokriminalitetit ka rëndësi të madhe preventive, sepse, përmes tij arrihen përpilimi dhe zbatimi i masave dhe i planeve parandaluese apo represive. Zbatimi me sukses i këtyre masave varet edhe nga faktorët fenomenologjikë dhe ata etiologjikë

---

<sup>29</sup> Rabije Dervishi, Viktimat e abuzimit me alkool dhe substancat narkotike, Tetovë, 2016

<sup>30</sup> Po aty



## **2.4. Viktimat e krimeve kundër njerëzimit, kundër luftës, dhe akteve terroriste**

Pos në Maqedoni, në vendet e tjera post-jugosllave zhvillohen gjykime për krime të luftës, të kryera në konfliktet e armatosura nga muaji janar i vitit 1991 deri në muajin qershor të vitit 1999. Për të gjitha gjykimet është karakteristike se zgjasin shumë dhe që viktimat nuk janë të informuara për përparimin e procedurës, në të cilën kanë dëshmuar.

Praktika e pabarabartë gjyqësore në zbatimin e ligjit në procesimin e krimeve të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë seriozisht e rrezikon barazinë e të dyshuarve, të të akuzuarve dhe të të dënuarve para ligjit.

Në Maqedoni nuk ka gjykime për krime të luftës. Ligji mbi Amnistinë është miratuar në vitin 2002, me çka është mundësuar amnistia e të gjithë pjesëtarëve shqiptarë të formacioneve të armatosura për të cilët ka pasur dyshime se kanë kryer krime të luftës, me përfundim në datën 6 shtator të vitit 2001.

Sipas këtij Ligji, amnistia nuk ka pasur të bëjë me të akuzuarit kundër të cilëve është ngritur procedurë para GJPNJ. Me nismën e partive politike shqiptare (Partia Demokratike e Shqiptarëve – PDSH, Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI), në datën 19 korrik të vitit 2011 është iniciuar procedura e votimit në Parlamentin e Maqedonisë për mbështetjen e shumicës për interpretimin autentik të Ligjit mbi Amnistinë.

Të njëjtën ditë, nisma është miratuar me 63 vota për kurse 29 kundër, me çka është hequr dorë nga drejtësia penale për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut gjatë konfliktit të armatosur në Maqedon.<sup>31</sup>

Pos në Maqedoni, në vendet e tjera post-jugosllave zhvillohen gjykime për krime të luftës, të kryera në konfliktet e armatosura nga muaji janar i vitit 1991 deri në muajin qershor të vitit 1999. Për të gjitha gjykimet është karakteristike se zgjasin shumë dhe që viktimat nuk janë të informuara për përparimin e procedurës, në të cilën kanë dëshmuar. Praktika e pabarabartë gjyqësore në zbatimin e ligjit në procesimin e krimeve të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë seriozisht e rrezikon barazinë e të dyshuarve, të të akuzuarve dhe të të dënuarve para ligjit.

Në procedurat për krimet e luftës, në nivel të entiteteve dhe të distriktit të Brçkos, zbatohet Ligji Penal i RSFJ-së, kurse Ligji Penal i BdheH zbatohet në Gjykatën e BdheH. Për shkak të kundërshtimit të Republika Srpska, e cila i referohet Marrëveshjes së Dejtonit, nuk ka Gjykatë Supreme në BdheH, arsye kjo për të cilën procedura ankimore është në kompetenca të Gjykatës së BdheH, e cila gjykimet i kryen

---

<sup>31</sup> “Gjenerali Trifunović: Nuk do të shkoj në gjykim”, faqja e internetit Radio Evropa e Lirë, 14 korrik i vitit 2010. [http://www.slobodnaevropa.org/content/general\\_trifunovic\\_optuzen\\_za\\_ratni\\_zlocin\\_u\\_sloveniji/2099828.html](http://www.slobodnaevropa.org/content/general_trifunovic_optuzen_za_ratni_zlocin_u_sloveniji/2099828.html).

në procedurën e shkallës së parë. Bartja e kompetencave për gjykim për krimet e luftës në gjykata më të ulëta shkon ngadalë.

Në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2011, në tërësi janë bartur 83 lëndë në gjykatat me kompetenca vendore. Prej tyre, në tërësi 52 lëndë janë caktuar në gjykatat në FBdheH, 27 në gjykatat në RS, dhe një lëndë në Gjykatën Themelore në distriktin e Brçkos në BdheH. Obligimet e reja të gjykatave kantonale dhe të qarkut e kërkojnë mbështetjen përkatëse teknike, profesionale dhe financiare, në mënyrë që gjykimet të zhvillohen në mënyrë profesionale dhe pa shkelje të së drejtës në gjykimin fer dhe të drejtë.

Instituti i pranimit të fajit, me pjesëmarrjen e shoqatave të viktimave në sjelljen e vendimeve mbi përmbarimin në rastin konkret, dëshmohet si një instrument përkatës i drejtësisë penale në raport me rrjedhën e madhe të kohës nga kryerja e krimeve të luftës, vjetërsia e viktimave dhe e dëshmitarëve dhe me nevojën e viktimave për të përjetuar pendimin publik dhe kërkimfaljen e kryerësve.

Gjykimet janë më intensivët në Gjykatën e BdheH, i cili që nga themelimi e deri në fund të vitit 2011 me vendime të plotfuqishme ka dënuar 88 persona dhe ka përfunduar gjithsejtë 78 raste për vepra penale të krimeve të luftës, krime kundër njerëzimit, gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të zakoneve ndërkombëtare të luftës.

Mbyllja e negociatave mbi kapitullin 23, mbi drejtësinë dhe të drejtat themelore ka sjellë, me anë të sinergjisë së kritikës së institucioneve ndërkombëtare dhe të organizatave të të drejtave të njeriut si dhe rekomandimit të Komisionit Evropian, deri te përmirësimi i kuadrit juridik në të cilin kryhet procesimi i krimeve të luftës në Republikën e Kroacisë. Me ndryshimet e Ligjit mbi zbatimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë është futur kompetenca ekskluzive e gjykatave të qarkut në Osijek, Rijekë, Split dhe Zagreb, si dhe mundësia e shfrytëzimit të provave të mbledhura nga GJNPJ në procedurat penale në Republikën e Kroacisë.

## **KAPITULLI I TRETË**

### **3. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË SHFAQJEN E VIKTIMIZIMIT**

Viktimizimi kriminal është një përvojë e frikshme dhe shqetësuese për shumë nga ne. Ndryshe nga përvojat normale të jetës, viktimizimi nuk kërkohet dhe nuk mirëpritet kurrë. Viktimat shpesh nuk kanë njohuri se kush ose ku të drejtohen pas krimit.

Ata ndihen të pasigurt dhe nuk dinë kujt t'i besojnë ose të mbështeten për mbështetje, mirëkuptim dhe ndihmë. Jo vetëm që vuajnë fizikisht, emocionalisht, psikologjikisht dhe financiarisht nga viktimizimi i tyre, ata gjithashtu shpesh janë të ngarkuar nga kompleksiteti i sistemit të drejtësisë penale. Faktorët që ndikojnë në viktimizimin janë:

Faktorët ekonomik, social të jashtë të mbrendshëm. Në nënkapitullin më poshtë do të sqarojmë këta faktorë një nga një.

### 3.1. Faktorët ekonomik

Reçensionit ose lulëzimi i ekonomisë ose edhe luhajtje të vogla të gjendjes ekonomike mund të nxisin krimet ekonomike. Mashtrimet me kreditë dhe mashtrimet me falimentimet janë krime ekonomike tipike në kohën e reçensionit pasi biznesmenët që janë në vështirësi për likuiditete kërkojnë që të përfitojnë kredi me anë të bilanceve të rreme ose në raste të tjera mungesa e burimeve, që tregon gjendjen e falimentit, mund të detyrojë drejtuesit e firmës që të manipulojnë librat e llogarive ose të fshehin apo të transferojnë pjesë të kapitalit përpara rënies së shoqërisë.

Në kohën e lulëzimit të ekonomisë mundësitë për fitime të mëdha mund të nxisin krijimin e shoqërive fiktive të cilat hyjnë në tregun e kapitalit për të thithur investime duke premtuar fitime të mëdha ose mund të nxisin mashtrimet nga firma të pasurive të paluajtshme nëpërmjet mbivlerësimit të pasurive për të siguruar hua më të larta se vlera reale e pasurive dhe kur vlera e pasurive fillon e bie këto firma nuk arrijnë të paguajnë më huatë apo kur mbivlerësimi i pasurive krijon kapital të lartë fiktiv ato fillojnë të mashtrojnë aksioneret e tyre.<sup>32</sup>

---

<sup>32</sup> Horst Entorf, Economic Factors of Victimization: Evidence from Germany, First published: 20 May 2015  
<https://doi.org/10.1111/geer.12075>

### 3.2. Faktorët social

Politika kriminale nuk është vetëm një instrument vëzhgimi. Ajo është arti i përgatitjes për krijimin dhe zbatimin e standardit penal në mënyrë që të merren rezultatet më të mira në luftën kundër krimit. Politika penale ka një ndikim të rëndësishëm në sistemin e parandalimit të krimit, duke u përpjekur për të krijuar një alternativë për atë që deri tani është konsideruar si e vetmja rrugë përpara nga Shteti: represioni "ex post" i veprës së kryer.

Parandalimi duhet të jetë një investim për të ardhmen me lidhje me të gjitha problemet e prognozës dhe vlerësimin e rezultateve. Hetimet empirike ofrojnë pak perspektivë dhe alternativën e zgjidhjeve mediokër të mbështetura nga konfirmime modeste të marra nga eksperimentet. Kriza e politikës penale tani ndjehet në mbarë botën. Stimulon kërkimin e mënyrave të reja për të zbuluar, si brenda, poashtu edhe jashtë ligjit klasik penal. Cilat janë faktorët që çojnë në testimin e mënyrave të reja, të jashtme, lidhur me ligjin tradicional të instrumentit penal?<sup>33</sup>

Ajo duhet, para së gjithash, të parandalojë kryerjen e krimeve, jo vetëm të ndëshkuara, por edhe ato të konsumuara. Dhe, për të bërë këtë, duhet të veprojnë në faktorët që lehtësojnë dhe përcaktojnë fillimin e krimit të njeriut në shoqëri.<sup>34</sup>

Ekzaminimi i përgjithshëm i çështjes në parandalimin e krimit të çon kryesisht në fushën e politikës sociale ku politika penale është e lidhur ngushtë. Konteksti social në të cilën jetojmë është subjekt i ndryshimeve të shpejta që mund të shkaktojnë plakjen e parakohshme të atyre kriterëve të konsideruara themelore në një mënyrë të caktuar dhe të çojë, për këtë arsye, në pamjaftueshmërinë e tyre në lidhje me programin e parandalimit.<sup>35</sup>

Kjo shpie gjithnjë e më shumë drejt një Europë të bashkuar, jo vetëm ekonomisht, por edhe ligjërisht. Vlerat kushtetuese mbi të cilat qëndron ligji penal i shtetit, parashtron kërkesën që të merren me ato që konsiderohen thelbësore për kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Europës. Ligji penal dhe ligji social do të harmonizojë në mënyrë optimale. Në aspektin e profilaksisë mund të konsiderohet një parandalimin e krimit që kryhet përmes ndërhyrjeve të drejtpërdrejta në shoqëri. Në këtë kontekst mund të zbatohet përmes masave parandaluese të politikës sociale. Reflektimi në sfondin politik penal ka të bëjë me ndërtimin e individit që të përshtatet në komunitet, të individit që ka hedhur themelet e para në favor kundër krimit.<sup>36</sup>Faktori social ndikon fuqimisht mbi sjelljen njerëzore edhe si pasojë e

---

<sup>33</sup> Elezi, Ismet. 2014. E drejta penale: Pjesa e posaçme. Botimet Kumi. Tiranë.

<sup>34</sup> Po aty

<sup>35</sup> Po aty

<sup>36</sup> Elezi, Ismet. 2014. E drejta penale: Pjesa e posaçme. Botimet Kumi. Tiranë.

devijimit, bazuar mbi platformën e kontaktit shoqëror me mjedisin rrethues. Është e rëndësishme, për këtë arsye, analiza e kujdesshme e kushteve mjedisore në të cilat njeriu ushtron personalitetin. Këto lidhje, që shumë studiues i argumentojnë me lidhjen ndërmjet krimit dhe kushteve sociale, kulturore, që hasen zakonisht në një komunitet të caktuar. Politika kriminale lufton për të identifikuar shkaqet kryesore të krimit. Kjo është e mundur vetëm nëqoftëse njohim faktorët që e përcaktojnë atë. Vetëm atëherë mund të fillojë një kërkim i drejtpërdrejtë për të gjetur mjete të veçanta: "Ky është qëllimi i politikës kriminale".<sup>37</sup>

Lidhje shkakësore midis krimit dhe faktorëve socialë. Hulumtimet kriminologjike, në vijim, janë përqëndruar gjithnjë e më shumë në një drejtim deskriptiv/përshkrues, duke neglizhuar problemin etiologjik. Krimi, si çdo veprim njerëzor, është produkt i vullnetit, madje edhe në individë konsiderohen "normalë", rrjedh prej predispozitave të caktuara për arsye të caktuara të brendshme që janë të ushqyer nga faktorët endogjenë dhe ekzogjenë.

Në disa raste, në të vërtetë, dënimi mund të veprojë në një nivel parandalues të frikësimit, sepse kjo është kuptuar dhe pranuar në vlerësimin e tij të plotë negativ. Në raste të tjera, megjithatë, parandalimi i përgjithshëm nuk është i mjaftueshëm, Prandaj, në analizën e shkaqeve që formojnë shtresën bazë në procesin e kriminalizimit, është thelbësore për të përcaktuar se si marrëdhëniet sociale mund të krijojnë efektet e sjelljes njerëzore të detyruar. Në të vërtetë, ajo është e një rëndësie parësore, për të theksuar ndikimin që proceset e ndryshme të socializimit në ndërgjegjen e njeriut.<sup>38</sup>

Me kalimin e kohës, asimilohen rregulla të sjelljes dhe vlerave të kulturës dominuese në një moment të caktuar historik. Së fundi, kur ajo arrin pjekurinë dhe autonominë e mendimit, fillon të zhvillohet në hapësirën e tyre personale brenda kufinjve të realizimit me të dhëna nga konteksti shoqëror dhe kulturor në të cilin jetojnë. Në këtë proces të ndërlikuar, ndodh një zhvendosje drejt brendësisë së standardeve aktuale. Me këtë rast, pritet që komuniteti të formojë një sistem vlerash që ndërlidhen me sjelljen sociale. Shumë faktorë dhe shumë subjekte bashkëveprojnë në këtë lloj të evolucionit: familja si vendi kryesor i përvojës mësimore; shkolla, qeliza e parë e sistemit social të një komuniteti; bota e punës, si një mjet për përmbushjen personale në komunitet.<sup>39</sup>

---

<sup>37</sup> Capie, D. (2011). Small arms, violence and gender in Papua New Guinea: Towards a research agenda. *Asia Pacific Viewpoint*, 52(1), fq. 42-55.

<sup>38</sup> Po aty

<sup>39</sup> Capie, D. (2011). Small arms, violence and gender in Papua New Guinea: Towards a research agenda. *Asia Pacific Viewpoint*, 52(1), fq. 42-55.

Këto elemente duhet të ndikojmë shumë në trajnimin e tij personal, në sfondin kulturor, në qëndrim social dhe ndërgjegjen. Përfshirja e qenies njerëzore në kontekstin e tij social, varion ndërmjet presioneve konformiste të ushtruara nga komuniteti drejt një rendi shoqëror të paracaktuar, dhe kjo ka nevojë për realizimin e pakushtëzuar të personalitetit. Ndërgjegja, si një moment i kontrollit personal i përcaktuar nga procesi i ndërkombëtarizimit, i lidhur me kulturën, besimet ideologjike, politike, fetare, është prekur në mënyra të ndryshme edhe nga sistemi juridik që përshkruan për herë të parë atë që është "e mirë" dhe atë që është "e keqe". Në fakt, shkencërisht është provuar se në mes të ndërkombëtarizimit të standardeve në ndërgjegjen individuale dhe autoritetin e tyre efektiv, ekziston një marrëdhënie reciproke: vetëm nëse sistemi individual i vlerave dhe stafit të vetë-kontrollit, kryesisht përkon me rregullat e ligjit. Kështu, mund të shprejsojmë që ato të kenë efikasitet të plotë dhe efektiv.<sup>40</sup>

Prandaj, faktorët e mjedisit dhe shërbimet personale sociale, janë thelbësorë në përcaktimin e procesit të socializimit dhe ndërkombëtarizimit të rregullave ligjore. Nëse ata çojnë në qëndrime dhe sjellje të paligjshme, sjellja e njeriut atëherë është një devijim shoqëror. Përpjekjet më të mira për të shpjeguar krimin dëshmojnë se të gjithë të interesuarit preokupohen rreth kuptimit të këtij fenomeni kompleks. Pra, në aspektin e parandalimit të krimit, në mënyrë të pashmangshme, socializimi përfundon duke u bërë gur themeli i çdo përpjekje për një parandalim të konsiderueshëm.<sup>41</sup>

Si ndodh kur njerëzit vijnë në kontakt me disa faktorë socialë jofunksionale? Për këtë arsye, unë e përsëris se politika e mirë sociale nga shteti prodhon një politikë të shkëlqyer penale. Kohët e fundit, në fakt, ka patur shumë ndryshime shoqërore që kanë shkaktuar forma të reja të krimit. Ndryshimi substancial në vlerat themelore si tregu i punës, kriza e ideologjive, kolapsi i institucioneve sociale bazë, po ndikojnë në sjelljen e individit në komunitetin shoqëror. Shpërndarja e rasteve në mesin e shtresave të ndryshme shoqërore, sot është ndjerë më ashpër.

Pabarazi në shpërndarjen e pasurisë e kanë ndjerë si një barrë e madhe, veçanërisht grupet e rinj, nga papunësia e shfrenuar dhe mungesa totale e politikave serioze sociale që përfshijnë probleme konkrete të tregut të punës. Emancipimi i shpejtë i të rinjve, edhe pse mbështeten në nivelin ideologjik, nuk është arritur në aspektin ekonomik dhe produktiv.<sup>42</sup>

Cilat janë rrugët për të mbijetuar në një shoqëri, si një mënyrë për të dalë me forcë nga një gjendje e mungesës absolute të çfarëdo mjeteve të jetesës? Me çfarë perspektivash politika sociale është në gjendje të ofrojë një alternativë për rrugët e tjera të mbuluara tashmë nga politika penale?

---

<sup>40</sup> Po aty

<sup>41</sup> Po aty

<sup>42</sup> Lak, R. et al. (1992). Final report on domestic violence. Report No.14. PNG Law Reform Commission: Boroko

Vetëm rekursi në të drejtën penale, nuk mund të jetë e vetmja mënyrë për të parandaluar krimin. Faza represive duhet të paraprijë politikën sociale që do të manifestojnë veten në një proces të gjerë të kriminalitetit të profilaksisë sociale dhe individuale, veçanërisht në lidhje me kategoritë e personave dhe mjedisëve të delikuencës. Kjo kërkon një politikë ekonomik dhe sociale që do të zvogëlojë mundësitë për krimin dhe shtyrjen drejt krimit.<sup>43</sup>

Për reduktimin e pabarazitë serioze të shoqërisë, politika penale tenton të përmbajë zgjerimin e pakontrolluar të fenomenit kriminal. Një politikë e dëshirueshme sociale është ajo që kujdeset për të ndryshuar strukturën e cila është e angazhuar në formimin e ndërgjegjes së re. Kjo shërben si një radikalist i ri, që është i pranishëm në të gjitha fushat e ndryshme të jetës, reformat e tregut të punës etj.<sup>44</sup>

Ekziston nevoja për reformën e madhe që komuniteti është duke pritur për një kohë të gjatë. Kjo duhet të prekë fushën sociale, juridike, ekonomike, administrative, politike, ideologjike dhe kulturore. Vetëm kjo mund të shndërrohet në trambulinë apo platformë dobiprurëse për në Shqipëri dhe Europë. Shanset më të mira për parandalimin e krimit social e politik, ndërlidhen pikërisht me integrimin organik midis të gjithë sektorëve të lartpërmendur.

Dënimet alternative reale me burg, janë në fushën ekonomike: tregtia e lirë, barazimi i taksave dhe përjashtimit aksioneve minimale absolute, sektori i punëve publike, parandalimi i varësisë së drogës dhe alkoolizmi, format e ndryshme të sigurisë sociale, politikat për punësim maksimale në fushën politike, respektimi i të drejtave individuale dhe sociale të përfshira në Kushtetutë, në teknologjinë shkencore.

Pasojnë përparimet mjekësore, subvencionimi i hulumtimit, implementimi i shpejtë i drejtësisë së përgjegjshme ndaj nevojave të viktimave, përhapja maksimale e teknologjive të reja në arsim, mbështetja dhe edukimi i fëmijëve të braktisur, respektimi i modernizimit të sistemit arsimor, dhe kështu me rradhë. Lufta kundër krimit kaplon kryesisht sektorin ekonomik, social dhe kulturor, dhe pse jo, edhe atë politik dhe penal.<sup>45</sup>

---

<sup>43</sup> Po aty

<sup>44</sup> Po aty

<sup>45</sup> Lak, R. et al. (1992). Final report on domestic violence. Report No.14. PNG Law Reform Commission: Boroko



### **3.3. Faktorët e jashtëm**

Kritikimi i përkufizimit të L.V. Frank, V.I. Polubinsky arrin në përfundimin se kur përcaktohet viktima e një personi të veçantë, nuk duhet të ketë të bëjë me ndonjë nga aftësitë e tij të rritura për t'u bërë viktimë e një krimi, por vetëm me një që lidhet drejtpërdrejt me ndonjë veçori të personalitetit dhe sjelljes së vetë viktimës ose me marrëdhëniet e tij specifike me dëmtuesin, dhe nga ana e tij përcakton viktimizimin individual si pronë të një personi të caktuar, të kushtëzuar nga cilësitë e tij shoqërore, psikologjike ose biofizike (ose kombinimi i tyre), duke kontribuar në një situatë të caktuar jetësore në formimin e kushteve nën të cilat ekziston mundësia e dëmtimit të tij nga veprime të kundërligjshme.<sup>46</sup>

Me fjalë të tjera, viktimizimi i një individi të veçantë është aftësia e tij e mundshme për t'u bërë viktimë e një krimi si rezultat i ndërveprimit negativ të tipareve të tij të personalitetit me faktorë të jashtëm.

#### **Viktimat e abuzimit dhe varshmërisë nga substancat narkotike**

Brengos fakti se si viktima paraqiten moshat relativisht të reja të popullatës (nga shkolla fillore). Faktorët e viktimizimit dhe varësisë nga drogat dehëse janë të mirënjohur dhe rëndom janë në ndërlidhje të ngushtë me gjendjen dhe raportet familjare, problemet sociale, streset, traumat psikike e shpirtërore dhe krizat në procesin e formimit dhe edukimit të gjeneratave të reja. Viktimat e drogave dehëse janë të përshtatshme për t'u manipuluar për qëllime të ndryshme. Në kohën e krizës janë në gjendje të ndërmarrin veprime e sjellje të pamenduara dhe të kryejnë edhe krime të ndryshme.<sup>47</sup>

#### **Faktorët e jashtëm të viktimizimit**

##### **Faktorët ekonomiko-socialë**

Skamja apo varfëria, papunësia dhe krizat ekonomike, krizat e banimit, migrimi dhe lëvizja e popullsisë, diskriminimi i të huajve, korrupsioni, mashtrimi i konsumatorëve etj. Si faktorë që drejtpërdrejtë ndikojnë në viktimizim.

##### **Faktorët politikë dhe konfliktet politike**

Faktorët e natyrës politike, si konflikte politike, luftërat, përndjekjet politike, abuzimi i pushtetit në dëm të qytetarit, diskriminimet në baza etnike, fetare, raciale, gjinore apo politike.

##### **Masmediat e shkruara dhe elektronike si faktorë të viktimizimit**

Kërkimet empirike dëshmojnë se mediet e shkruara dhe ato elektronike janë faktorë të fuqishëm, si në paraqitjen ashtu edhe në parandalimin e viktimizimit të njerëzve.

<sup>46</sup> Polubinsky, V. I. (1979). Legal basis of the doctrine of crime victim. Gorky.

<sup>47</sup> Minskaya, V. S., & Chechel, G. I. (1988). Victimization factors and the mechanism of criminal behavior. Irkutsk: Irkut University Press.

### **Familja dhe rrethanat familjare si faktorë të viktimizimit**

Kriza e madhe që ka përfshirë familjen, shkollën dhe mjedisin social, ka shtuar edhe faktorët e rrezikut për viktimizim. Në këto raste shpesh fëmijët janë viktima “Memece”, viktima që nuk flasin, për shkak të ligjit të “heshtjes” që atyre u imponohet në ambientin familjar.

### **Disa sëmundje sociale si faktorë të viktimizimit**

Viktimat e perversioneve në praktikë, shpesh janë të lidhura me ndikimin e narkotikëve apo pijeve të ndryshme alkoolike.<sup>48</sup>

---

<sup>48</sup> Minskaya, V. S., & Chechel, G. I. (1988). Victimization factors and the mechanism of criminal behavior. Irkutsk: Irkut University Press.

### 3.4. Faktorët e brendshëm

Faktorët subjektivë/individualë mund të kenë bazën në ndikime të natyrës biologjike dhe psikike. Sipas shpjegimeve biologjike, viktimizimi i personave ndodh për shkak të vetive dhe cilësive të natyrës anatomike dhe biologjike. Dinamika e viktimizimit masiv është komplekse për sa i përket varësisë së saj funksionale.

Nga njëra anë, viktimizimi ndryshon në lidhje me ndryshimet sasiore dhe cilësore të krimit, nga ana tjetër, në përbërësin e mundshëm dhe jo në lidhje me ndryshimet e tij, viktimizimi ndryshon "më herët" të krimit, dhe kjo tashmë përfshin një ndryshim në këtë të fundit. Viktimizimi është një fenomen që realizohet në tre nivele: njëjës, i veçantë dhe i përgjithshëm.

Në nivelin e vetëm, kuptohet që dëmi është realizuar nga një veprim kriminal ose potenciali i mbetur i një individi për t'u bërë viktimë e një krimi në kushte dhe rrethana të caktuara. Në një nivel të veçantë, duhet të konsiderohet viktimizimi i grupeve të caktuara të popullsisë (fëmijë, gra) ose në zona të caktuara të veprimtarisë (profesionale, shtëpiake). Në një nivel të përgjithshëm, viktimizimi shihet si një fenomen masiv.<sup>49</sup>

Procesi i viktimizimit përfshin një sistem kompleks të fenomeneve që lidhen me pjesëmarrjen e viktimës në formimin e një motivi kriminal, ndërveprimin me autorin e veprës në një situatë specifike të jetës, me kryerjen e një krimi të dhunshëm ndaj saj, duke sjellë pasoja të caktuara kriminale. Në këtë drejtim, dallohen katër nivele të viktimizimit, ndërsa merren parasysh si parametrat e viktimizimit të individit ashtu edhe parametrat e viktimizimit të grupeve shoqërore.

- Niveli i parë përfshin të dhëna për viktimat e drejtpërdrejta të krimeve të dhunshme që shfaqen në materialet e çështjeve penale, ose për viktimat latente të identifikuara si rezultat i hulumtimeve viktimologjike dhe dëmet e shkaktuara atyre.
- Niveli i dytë përmban të dhëna për anëtarët e familjes së viktimës të cilët janë prekur indirekt nga krimet e kryera kundër të dashurve të tyre.
- Niveli i tretë përbëhet nga grupe të tjera shoqërore (kolektivë pune, miq, të njohur, fqinjë, etj.), të cilat gjithashtu dëmtohen si rezultat i një efekti indirekt të krimit.
- Niveli i katërt (shoqëror) supozon ekzistencën e pasojave negative të kryerjes së një krimi për të gjithë rajonin ose tërë shoqërinë.

---

<sup>49</sup> A. L. Repetskaya. Komanda fajtore e viktimës dhe parimi i drejtësisë në politikën kriminale. Irkutsk, 1994

## **KAPITULLI I KATËRT**

### **4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

#### **VIKTIMAT E VRASJEVE NË TERRITORIN E TETOVËS**

Për realizimin e këtij punimi gjatë hulumtimit do të aplikoj metoda bashkëkohore që zbatohen në shkencat shoqërore. Metodologjia e cila do të aplikohet gjatë hulumtimit të punimit do të përmbajë metoda teknike relevante kërkimore hulumtuese.

Në hulumtim do të shfrytëzohet literatura përkatëse bashkëkohore studimore si: libra universitar, revista shkencore, punime profesionale – shkencore, shënimet nga evidencat e institucioneve administrative, gjyqësore, prokuroriale, etj. Po ashtu do të shfrytëzohen edhe burimet e hapura siç janë web - faqet e ndryshme të internetit dhe analiza e raporteve vjetore të institucioneve të ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare në Maqedoninë e Veriut. Vetë natyra e cila do të jetë objekt studimi kërkon që të zbatohen edhe metoda të caktuara shkencore.

Metodat të cilat do të përdoren janë:

Metoda historike - gjatë hulumtimit shkencor të një fenomeni rëndësi të posaçme duhet ti kushtojmë metodës historike nëpërmjet së cilës do të shqyrtohet ekzistenca dhe evoluimi i viktimave në aspektin historik, forma dhe mënyrat e paraqitjes në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë.

Metoda e analizës juridike - me anë të kësaj metode do të arrihet të evidentohet aspekti juridik i veprës penale e cila sjell deri tek viktimizimi. Përmes kësaj metode do të paraqiten: definicioni dhe kategoritë e viktimave, karakteristikat, pasojat dhe segmente tjera që e karakterizojnë atë.

Metoda e analizës teorike - gjatë hulumtimit kërkimor do të përdoret metoda e analizave teorike të viktimave, duke konsultuar literaturën përkatëse.

Metoda statistikore – me anë të kësaj metode do të grumbullohen të dhënat statistikore të evidentuara si të dhëna zyrtare për vrasjet, llojet e tyre, etj. Këto shenime do të hulumtohen në Polici, Prokurori, dhe Gjykatë. Përmes metodave të lartcekura do të mundohem që ta njoh, trajtoj dhe analizoj në baza shkencore dukurinë e viktimave si dhe të propozoj masat adekuate preventive dhe represive me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie.

**4.1 VIKTIMAT E VRASJEVE NË TERRITORIN E TETOVËS**  
**PRAKTIKA GJYGJËSORE NË GJYKATËN THEMELORE TË TETOVËS NË LIDHJE ME RASTET**  
**E VRASJEVE**

**Tab 1. Numri i lëndëve për vrasje**

Viti	Numri i lëndëve për vrasje
2008	9
2009	12
2010	18
2011	13
2012	9
2013	7
2014	15
2015	15
2016	7
2017	8
2018	8

*Sipas kësaj tabele mund të vërehet se më shumë lëndë për Vrasje në këta dy pjesë kemi në vitin 2010, me 18 lëndë për vrasje që janë paraqitur në Komunën e Tetovës kurse më pak lëndë për Vrasje janë paraqitur në vitin 2013 dhe 2016 me 7 lëndë për vrasje.*

## 4.2. Rastet e vrasjeve në Tetovë

Si pjesë metodologjike në punim tim kam marrë parasysh edhe analizën e vendimeve për vrasje në Tetovë, për qëllime masteri kemi marrë 10 vendime që ti analizojmë për periudhën 2008-2018.

Sipas vendimit **nr.K-586.08**

Gjykata Themelore e Tetovës është Gjykatë Themelore në vendin tonë, nga viti 2008 kemi nxjerrë vendimin me nr.K-586.08 vendim në të cilin flitet për veprën penale VRASJE, me nr anëtarësie 123, fq.1 nga Kodi Penal.

S. B me datë 20.07.2008 rreth orës 02.30 përpara kafes Alfa-Bar me lokacion në Sinican është kryer vepër penal rast vrasje. Vrasja është kryer me armë automatike e kalibrit 7.62.

Sipas vendimit **n.K.770.09** të marrë nga Gjykata e Tetovës personi A.A ka rrezikuar rrezik të përgjithshëm. Sipas vendimit të marrë nga gjykatësja SH.A me datë 02.09.2009 rreth orës 20 afër stadiumit të qytetit ka debatuar verbalisht dhe nga kjo ka ardhë deri në dhunë fizike. Shkaku i debatit verbal ka ardhur se personi në fjalë i ka pasur para borxh dikuj, debate verbal u keqësua ende më shumë deri sa erdh në fjale edhe plumbat dhe dhe thika. Personi në fjalë është akuzuar me burg 8 muaj dhe me pagesë 2.000 den në emër të shpenzimeve dhe në afat 30 ditë të merret gjykimi rëndë. Po ashtu personit të akuzuar i janë marrë arma dhe thika.

Sipas vendimit **nr. K-649.10** të marrë nga Gjykata e Tetovës personi D.R është akuzuar për vepër penale. I akuzuari në fjalë para hotelit Joco Komerc në fshatin Saracinë, në gjendje të dehur 1.75 promila ka kryer vepër penale dhunë fizike mbi K.T i akuzuari ka nxjerrë pistoletën e tij dhe ka gjyajtur në kamë. Sipas këtij vendimi kemi dënim me burgim 1 vit. Po ashtu edhe në Gjykatë duhet të kryer një pagesë prej 2000 denarëve dhe 37.000 den në kohë prej 30 ditëve.

Sipas vendimit **nr.K.713.11** M.M ka marrë aktakuzë me datë 15.05.2010 rreth orës 01.20 në Tetovë afër hotelit ABA. Hoteli ABA ishte nën pronësi të babait të tij. M.M ka tentuar që të fshi nga jeta shërbyesen hotelerike me origjinë nga Kosova.M.M në ora 01 kur ka arritur tek ABA ka kërkuar nga shërbyesja ti sjellë kafe, mirpo kur ai ka dëshiruar që të blejë atë ajo e ka refuzuar dhe personi i lënduar j aka goditur kokën dhe ka nxjerrë thikë dhe ka lënduar trupin e saj . Vendimi i marrë nga Gjykata për M.M është marrë për 4 vite e 6 muaj burgim.

Rastet nuk ndalen sipas vendimit **nr.K-58.12** të marrë nga Gjykata Themelore e Tetovës kemi, Z.L i cili me datë 12.01.2009 rreth orës 21 në fshatin Pirok në afërsi të shtëpisë së A.Z ka tentuar tentativë për vrasje ndaj A.Z. A është shëtitur i lirshëm në drejtim të shtëpisë së itij personi në fjalë del

jap ret rrugën me thikë ku tre her e dëmton trupin e tijë. Nga të akuzuarit në fjalë Gjykata ka sjellë vendim se ai ka kryer vrasje dhe është dënuar me 3 vite burg.

Në vitin 2013 kemi rastin e marrë me **nr.K-789.13**, i marrë në Gjykatën Themelore të Tetovës. Sipas këtij vendimi A.A me datë 08.06.2013 rreth orës 19 në Tetovë, në afërsi të Rimit A.A ka tentuar për vrasje M.J e ka vrarë me thikë personin tjetër në fjalë. A.A është dënuar me 4 vite burg për vrasje.

Sipas vendimit të marrë në me **nr.K.443.14** kemi A.A me datë 10.05.2014 rreth orës 14,në fshatin Lërc, ka realizuar tentativën e vrasjes M.A në mënyrë barbare ka krzer vrasje. Personi në fjalë është dënuar me 3 vite burg.

Rasti i radhës i marrë në Gjykatën e Tetovës me **nr.K-742.15**, i dënuari A.Sh me datë 29.06.2010 rreth orës 20.15 ka vendorus që të kryej tentativë vrasje ndaj kushëririt F.SH i cili e priste tek Metro Petroll personi i dënuar A.SH ka shtënë me armë zjarri 4 her mbi kushëririn e tij. Personi në fjalë është dënuar me 3 vite burg,

Në Gjykatën e Tetovës po ashtu ëshë marrë një aktakuze dhe një vendim mbi vrasje. Rasti me **nr.K-139.16** Z.A me datë 16.08.2013 rreth orës 16.40 në Tetovë ka kryer vrasje ndaj R.A. Vrasjen e kryen me thikë. Sipas Kodit Penal të RMV personi në fjalë dënohet më burg 3 vite.

Për qëllime të masterit kemi marrë periudhën 2008-2018, sipas kësaj periudhe për secilin vit janë marrë nga një rast për hulumtim. Vlen të theksojmë se në vitin 2017 është marrë rastin me **nr.K-163.17** Z.A rreth orës 15 në afërsi të Arabati Baba Teqe ka kryer vepër penale vrasje ndaj personit R.A, i akuzuari në fjalë është dënuar me 3 vite burg dhe i është konfiskuar thika më të cilën e vrau në krahëror R.A

Sipas vendimit të marrë me **nr.K-120.18** kemi të akuzuar tre persona, të akuzuarit B.M, A.B dhe H.K janë të akuzuar për vrasje. A ka detyruar B që të vrasë personin me initiale J.L të tre të akuzuarit janë dënuar me 40 vite burg.

### **4.3 METODA E ANALIZËS SË TË DHËNAVE SASIORE**

Për mbledhjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave të pyetësorit është përdorur metoda e mbledhjes dhe zbritjes, mesit aritmetik dhe grafikonëve në Exell. Është realizuar me GOOGLE.doc shkaku i pandemisë dhe rezultatet e marra do të shqyrtojmë si rezultate për aporvimin e hipotezave dhe realizimin e pyetjeve kërkimore.


#### **ANKETA DHE PËRMBAJTJA E SAJ**

1. A mendoni se ekzistojnë forma të ndryshme të viktimave në RMV?
2. A jeni të mendimit se RMV ka kontroll të pamjaftueshëm institucional?
3. A jeni të mendimit se mosfunksionimi i duhur dhe efikas i sistemit gjygjës na sjell problem mbi proceset gjygjësore?
4. Cilat janë faktorët të cilat ndikojnë në paraqitjen e viktimave ? Retho ndonjë përgjigje
5. Cilat janë format e viktimave në Maqedoninë e Veriut dhe me theks të veçantë tek vrasjet në Tetovë ?




### Interpretimi dhe paraqitja e rezultateve nga pyetësi i realizuar.

Mostra e të anketuarëve është në Komunën e Tetoves, në këtë punim për shkaqe të punimit të masterit. Kemi anketuar rreth 150 persona. 57% e mostrës së anketuar kanë qenë femra, kurse 43% tjetër kanë qenë të gjinisë mashkullore.




**Grafiku 1.** Numri i të anketuarëve

Kategoria e pjesëmarrësve sipas moshës ka qenë e ndryshme. Moshë në mostrën tonë është 20 deri 45 vite. Moshë e eminentë me përqindje më të madhe që ka marrë pjesë në plotësimin e këtij pyetësi është moshë 31 deri 35 me përqindje më të madhe (50%).




**Grafiku 2.** Moshë e të anketuarëve



**Grafiku 3. Statusi i punësimit**

Për shkak se statusi i punësimit ka një ndikim dhe konsiderohet si një ndër faktorët relevant për Vrasje janë marrë informata se 64% e respondentëve janë të punësuar, ndërsa 36% e tyre jo.


1. A mendoni se ekzistojnë forma të ndryshme të viktimave në RMV?



**Grafikoni nr.1 A mendoni se ekzistojnë forma të ndryshme të viktimave në RMV?**

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se ekzistojnë forma të ndryshme të viktimave në RMV. 93% kanë deklaruar se po dhe një gjë e tillë na jep aporvim të Hipotezës së parë.


2. A jeni të mendimit se RMV ka kontroll të pamjaftueshëm institucional?



**Grafikoni nr2 A jeni të mendimit se RMV ka kontroll të pamjaftueshëm institucional?**

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se RMV ka kontroll të pamjaftueshëm institucional 57% kanë deklaruar se po, pohimi i tyre na jep edhe mundësinë e aprovimit të Hipotezës së dytë në punimin tonë master.

3. A jeni të mendimit se mosfunksionimi i duhur dhe efikas i sistemit gjygjës na sjell problem mbi proceset gjygjësore?




**Grafikoni nr.3 A jeni të mendimit se mosfunksionimi i duhur dhe efikas i sistemit gjygjës na sjell problem mbi proceset gjygjësore?**

Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se 59% kanë deklaruar se janë të mendimit se mosfunksionimi i duhur dhe efikas i sistemit gjygjësor na sjell problem mbi proceset gjygjësore. Po ashtu më përqindjet e marra nga ky grafikon kuptojmë se edhe hipoteza e tretë është aprovuar.

Mosfunksionimi i duhur dhe efikas i sistemit gjyqësor. Kolapsi gjyqësor, mungesa e stafit gjyqësorë, lëndët e grumbulluara, parashkrimi i lëndëve, proceset gjyqësore të tej zgjatura, mungesa e efikasitetit gjyqësor etj., janë disa nga shkaqet që viktimat në Maqedoni janë evidente në shumë segmente të jetës.


#### 4. Cilat janë faktorët të cilat ndikojnë në paraqitjen e viktimave ? Retho ndonjë përgjigje



**Grafikoni nr.4 Cilat janë faktorët të cilat ndikojnë në paraqitjen e viktimave ? Retho ndonjë përgjigje**

Sipas këtij grafikoni nënkuptojmë se të anektuarit janë të njoftuar rreth faktorët që paraqesin viktimat. 53% kanë deklaruar se faktorët që ndikojnë në paraqitjen e viktimizimit janë ata social, ekonomik, të jashtëm dhe të brendshëm.

5. Cilat janë format e viktimave në Maqedoninë e Veriut dhe me theks të veçantë tek vrasjet në Tetovë ?



**Grafikoni nr.5 Cilat janë format e viktimave në Maqedoninë e Veriut dhe me theks të veçantë tek vrasjet në Tetovë ?**

Sipas këtij grafikoni kemi se format e viktimave në RMV më shumë që paraqiten janë viktimizimi gjinor, viktimizimi seksual, viktimizimi i vrasjeve.

## **PËRFUNDIMI**

Dukuria e viktimave në Maqedoninë e Veriut mbetet një ndër sfidat kryesore të saj. Viktimizimi si dukuri e cila dita ditës po ngulfat shoqërinë shqiptare dhe maqedonase, paraqet rrezik permanent për ekonominë dhe shoqërinë demokratike në përgjithësi.

Sa është i shprehur viktimizimi në një shoqëri, pasqyron gjendjen shoqërore, politike dhe sigurinë nacionale të një shteti. Si e tillë ajo paraqet kërcënim edhe për sigurinë ndërkombëtare të një regjioni të caktuar të shteteve. Prandaj në të gjitha shtete bashkëkohore -demokratike ku mirëqenia e qytetarit është prioritet i politikës shtetërore, parandalimi dhe luftimi i dukurisë së viktimizimit është pjesë e strategjisë zhvillimore të çdo qeverie.

Duke pas parasysh që veprat penale kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave ligjore, kodit të etikës profesionale nga kryesit e veprës, me qëllim të përfitimit të paligjshëm të pasurisë apo të krijimit të benefiteve të caktuara për veti apo për personat e tjerë, dukuria e viktimizimit paraqet shkelje të rendit kushtetues dhe të drejtat dhe lirive themelore të njeriut.

Viktimizimi manifestohet në forma të ndryshme në një shoqëri, si: dhënie dhe marrje e ryshfetit, shantazhi, vrasje, vjedhje, mashtrime, dhunim etj. Prandaj kjo dukuri shkakton pasoja të mëdha sociale, politike, ekonomike dhe të sigurisë.

Një sfidë në vete paraqet edhe identifikimi i shkaqeve të viktimave me qëllim të parandalimit dhe luftimit sa më efikas të saj. Në luftimin e kësaj dukurie rol të rëndësishëm luajnë institucionet gjyqësore, prokuroriale dhe mediat e lira, sidomos gazetaria hulumtuese. Të gjitha këta faktorë ndikojnë në parandalimin dhe luftimin sa më efikas të dukurisë së korrupsionit në shoqërinë tonë.

Infrastruktura ligjore e Republikës së Maqedonisë respektivisht dispozitat e Kodit Penal parashohin veprat penale të viktimave, mirëpo implementimi i tyre nuk është i kënaqshëm dhe i mjaftueshëm për parandalimin e kësaj dukurie kriminale nga ana e institucioneve të gjyqësisë dhe prokurorisë.

Shoqëria maqedone dhe shqiptare, institucionet shtetërore, shoqëria civile gjinden para një sfide të quajtur luftimi për mbrojtjen e viktimave. Kjo sfidë duhet të tejkalohet me qëllim që shteti i Maqedonisë së Veriut ti plotësojë kriteret e kërkuara nga bashkësia ndërkombëtare për lëvizjen e lirë të popullatës maqedonase dhe shqiptare në shtetet e Bashkësisë Evropiane.

Trajtimi i viktimës së krimit, në veçanti çështja e mbrojtjes juridike të saj është një nga problemet me të mëdha të sistemit të drejtësisë penale dhe preokupim i opinionit profesional në përgjithësi.

Të drejtat të cilat u takojnë viktimave të krimit me parashikimin e tyre në dokumente ndërkombëtare dhe nacionale janë ngritur në nivel të të drejtave ligjore dhe si të tilla konsiderohen pjesë integrale e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Mirëpo në nivel nacional në RMV si edhe në disa vende të tjera mbetet shumë aktuale nevoja për nxjerrjen e normave juridike nga kjo fushë me qëllim të garantimit se viktimat e krimit të ketë mbrojtje juridike adekuate prej momentit të pësimit e deri në përfundim të çështjes penale në lidhje me të

Studimet dhe hulumtimet e ndryshme që janë bërë tregojnë se për një luftë efektive kundër kriminalitetit, përveç gjyqimit dhe dënimit të kryesit është e domosdoshme që edhe subjektit tjetër të aktit kriminal t'i ofrohet ndihmë adekuate.

Me rastin e ndërmarrjes së masave me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së nevojshme juridike duhet të merren në konsideratë nevojat specifike dhe pozita delikate e viktimës si rezultat i ndikimit të viktimizimit në të.

Gjithashtu duhet të pranohet se humbjet e viktimës mund të jenë të shumta dhe të natyrave të ndryshme si: dëmtime fizike, vuajtje shpirtërore, humbja e të afërmeve dhe humbja në aspektin financiar. Këto humbje rekomandohet që të merren në konsideratë edhe nga një numër i madh i akteve ndërkombëtare që trajtojnë problemin e të drejtave të personave që kanë pësuar nga krimi.

Si zgjidhje për të ardhmen, sidomos për ato vende që nuk kanë krijuar sa duhet kushte për përmirësimin e pozitës së viktimës, do të ishin:

- Nxjerrja e ligjeve, me qëllim të krijimit të parakushteve juridike për mbrojtjen e interesave të viktimës që ka pësuar nga krimi. Zgjidhja më e mirë në këtë drejtim do të ishte që këto ligje të jenë në harmoni me standardet e përcaktuara në mënyrë parimore në aktet ndërkombëtare nga kjo fushë, por duke marrë për bazë edhe nevojat reale të vendit përkatës.
- Informimi i viktimave të krimit për të drejtat ligjore që ato i kanë si persona që janë dëmtuar. Një informim i tillë do të realizohej në formë të ndryshme si p.sh. me krijimin e qendrave për informim të viktimave, shpërndarjen e informacioneve nëpërmjet mjeteve elektronike dhe atyre të shkruara etj.
- Mbi bazë ligjore krijimi i mekanizmave të domosdoshëm që mundësojnë realizimin e ndihmës për viktimat e krimit. P.sh. qendrave speciale për dhënien e ndihmës, ofrimit të mbrojtjes, strehimit dhe rehabilitimit të viktimave.



- Aftësimi i kuadrit profesional që ka për obligim të merret me viktimat e krimit prej kontaktit të parë e deri në përfundim të çështjes penale në lidhje me të, në mënyrë që të njohin të drejtat ligjore të viktimave dhe qasja ndaj viktimave të jetë në përputhje me gjendjen delikate të tyre.
- Krijimi i fondeve shtetërore dhe fondeve të tjera për realizimin e kompensimit si një nga të drejtat kryesore për viktimat.
- Krijimi i bazës ligjore për të vepruar organizatat joqeveritare dhe shoqatat bamirëse të cilat kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e krimit dhe krijimin e fondeve për kompensimin e dëmit që ato kanë pësuar nga krimi.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të masave për mbrojtje dhe kompensim të viktimave të krimit, sidomos sa i përket këmbimit të përvojave nga kjo fushë ndërmjet shteteve të ndryshme. Në veçanti kur është fjala për viktimat e krimeve transnacionale.

Në legjislacionin maqedonas janë përfshirë vetëm pjesërisht format e dhunës seksuale. Përkatësisht, përdhunimi dhe prostitucioni i detyruar njihen si vepra penale. Llojet e tjera të dhunës seksuale të tilla si abuzimi seksual dhe të gjitha aktet që i përfshin nuk janë të përcaktuara qartë dhe është lënë në interpretimin e lirë të gjykatës dhe prokurorisë.

Vendimi për atë çfarë përfshihet në termin "akt seksual", si dhe peshën e tij, sillet nga prokuroria. Mungesa e termit "akt seksual" gjithashtu çon në mosnjohjen e të gjitha akteve që nënkuptojnë dhunë seksuale.

Viktima mund të marrë ndihmën dhe mbështetjen në organizatat e qytetarëve, por në këtë sektor nuk ka servise të specializuara për këtë formë të dhunës me bazë gjinore, përkatësisht mbështetjen më shpesh e ofrojnë organizatat të cilat janë të fokusuara kryesisht në mbrojtjen e grave viktime të dhunës në familje.

Të zgjerohet spektri i veprave penale që mund të trajtohen me ndërmjetësim . Duke qënë se dhe tek pyetësorët u vu re se individët për shkak të arsyeve ekonomike kryenin më shume vepra penale si vjedhja. Të ketë një kënd informimi për të gjitha qytetarët në institucionet e drejtësisë , ku çdo qytetar të marrë një informacion të detajuar dhe të kuptueshëm .

Për të shmangur pjesën e konflikteve që janë burimi kryesor ku përshkallëzohet më tej në kryerjen e veprave penale apo dhe kundravajtjeve duhet që pesë komponentët e socializimit të individit duhet të jenë në harmoni dhe në bashkëveprim të vazhdueshëm me njëri –tjetrin.

Këto mënyra alternative të bëhen pjesë e programeve të detyrueshme të arsimit nëpër shkolla, si lëndë të cilat të shoqërohen dhe me anën praktike, ku gërshtimi i teorisë dhe praktikës të ketë efikasitet të lartë tek çdo nxënës që është i mitur.

Në këtë mënyrë rritet ndërgjegjësimi dhe kultivohen këto mënyra për të mos e përshkallëzuar më tej një konflikt. Për të informuar publikun e gjerë një mënyrë informuese do të ishin dhe fletëpalosjet që mund të shpërndahen, duke kultivuar një mendim të ri larg mentaliteti të vjetër. Pra zgjidhja e konflikteve larg mënyrës tradicionale që është procesi gjyqësor por duke u fokusuar tek mënyrat e reja , gjithmonë vetëm për ato çështje të cilat ligji i parashikon.

### **Aktualiteti dhe interesi për studime viktimologjike**

Problemi i viktimës mund të shtrohet si çështje që ka të bëjë me dukurinë ose rastet e pësimit nga veprimi kriminal dhe kundërligjor.

### **Kuptimi i viktimologjisë**

Viktimologji do të thotë shkencë mbi viktimën e cila merret me çështjet themelore të viktimizimit të njerëzve nga veprimet apo mosveprimet kriminale dhe kundërligjore.

### **Kuptimi i viktimës dhe viktimizimit**

Fjala viktimë nënkupton personin ose grupin e caktuar që ka pësuar, që është dëmtuar. Pësimi apo viktimizimi ka të bëjë me privimin nga jeta, me dëmtimin e integritetit trupor, me shkatërrimin e shëndetit fizik dhe mental, me ngeljen me pasoja të rënda fizike dhe psikike afatshkurtra ose afatgjata.

- Viktimë konsiderohet personi i cili nga veprimi kriminal ka pësuar cenimin, shkeljen apo rrezikimin e ndonjë të mire a të drejte personale.
- Viktimizim kuptohet kur nuk ka veprim të drejtpërdrejtë kriminal, por pësimi shkaktohet për arsye tjera (vetëvrasja, viktimat e fatkeqësive etj)

### **Lënda e viktimologjisë**

Lëndë studimi janë viktimat, format e viktimizimit, shkaqet dhe procesi i viktimizimit, faktorët apo shkaktarët, mbrojtja e viktimave, ndihma e viktimave, zhdëmtimi dhe kompensimi i viktimave dhe parandalimi i viktimizimit të njeriut në përgjithësi..

Si lëndë duhet të konsiderohen viktimat humane dhe procesi i viktimizimit të njeriut si dhe viktimat e botës shtazore dhe bimore ngase kanë lidhje me mirëqenien e njeriut në këtë planet.

Përkufizimi i ngushtë apo restriktiv i lëndës së viktimologjisë

Viktimologjia është disiplinë e pavarur shkencore e cila merret me studimin e viktimave dhe procesin e viktimizimit të personave që pësojnë nga veprimet apo mosveprimet kriminale dhe kundërligjore.

### **Përkufizimi i gjerë apo ekstensiv i viktimologjisë**

Lëndë dhe objekt i shkencës së viktimologjisë duhet të jenë gjitha rastet e viktimizimit direkt apo indirekt të njerëzve dhe qenieve të tjera të botës shtazore dhe bimore.

### **Disa kuptime dhe nocione: viktimë, viktimizim, viktimitet**

- Viktimë (humane) nënkuptohet personi apo njeriu që ka pësuar nga veprimi ose mosveprimi kriminal, njeriun të cilit i atakohen dhe cenohen të mirat e tij materiale, morale, të drejtat e tij të parapara me ligj.
- Viktimë (shtazore) kanë të bëjnë me procese e veprime që shkaktojnë rrezikimin dhe zhdukjen e specieve të botës shtazore.
- Viktimë (bimore) kuptojmë shfarosjen, zhdukjen e llojeve të ndryshme të bimëve përgjithmonë.
- Viktimizim kuptohet procesi i pësimit të njeriut (mënyrat, rrugët, trajtat e dëmtimit, shkallën dhe intensitetin e përjetimit të cenimit të të drejtave, të lirive dhe të të mirave të një personi nga veprimi i një personi apo shumë personave të tjerë, i cili është kundërligjor.
- Viktimitet nënkuptohet tërësia e rasteve viktimizuese, që kanë ndodhur në një vend brenda një periudhe të caktuar kohore. Indikatorë janë: rënia, rritja dhe parametra të tjerë.
- Viktimizimi primar zakonisht kuptohen rastet kur një person për herë të parë pëson, dëmtohet ose viktimizohet nga veprimi i qëllimshëm i kryerësit.
- Viktimizimi sekondar nënkuptohen rastet e pësimit dhe të dëmtimeve që ndodhin gjatë trajtimit lidhur me realizimin e të drejtave të tyre në organet kompetente.
- Mbrojtja e viktimave nënkuptohen të gjitha veprimet e bazuara në norma ligjore lidhur me ofrimin e ndihmave dhe mbrojtjen e viktimave që kanë pësuar nga cenimet dhe atakimet kriminale.
- Të drejtat e viktimave nënkupton një tërësi të të drejtave që u janë ngarkuar viktimave të krimit apo të keqpërdorimit që pushtetit, e që janë të parapara me akte ndërkombëtare dhe dispozita pozitive ligjore.
- Kompensimi dhe dëmshpërblimi i viktimave nënkuptojmë veprimet ligjore të organeve të ndryshme me qëllim që personit apo familjes së atij që ka pësuar dëme materiale, dëme pasurore, dëm moral dhe frikë e dhimbje, t'i kompensohet ajo në masë dhe kohë të përshtatshme.

- Kategoritë e rrezikut ose faktorët e rrezikut janë mosha, gjinia, fëmijët, pleqtë, të sëmurët, të huajt, pakicat, përkatësia religjioze, politike, raciale, varfëria, papunësia etj.

Drejtësia restorative apo e drejta e ndërmjetësimit për kompensim kuptohet një aktivitet të degëzuar dhe të planifikuar mirë në qëllim që arrihet një pajtim midis kryesit dhe viktimës, duke kompensuar viktimën.

### **Kontributi i studimeve kriminologjike**

Kërkimet bashkëkohore kriminologjike i kanë ndihmuar shumë viktimologjisë që duke shfrytëzuar modelet e tilla kërkimore të avancojë metodat dhe metodologjinë kërkimore të saj.

### **Kontributi i studimeve psikologjike**

Në bazë të orientimeve të psikologjisë klinike, të aplikuar dhe të personalitetit, është arritur të plotësohen njohuri të vlefshme për shkaqet dhe format e viktimizimit, për mënyrat rreth rehabilitimit dhe mbrojtjes së viktimave.

### **Kontributi i studimeve sociologjike**

Studimet dhe kërkimet mbi familjen, ambientet sociale, studimet mbi problemet e patologjisë sociale dhe reflektimin e tyre në viktimizimin e njerëzve ka ndihmuar shumë viktimologjisë në trajtimin shkencor të viktimave të tilla dhe mbrojtjen më të suksesshme të tyre.

### **Kontributi i studimeve të mjekësisë forenzike**

Studimet e mjekësisë forenzike dhe të psikiatrisë gjyqësore kanë kontribuar në caktimin e kritereve më objektive për klasifikimin dhe llojin e kompensimit për vuajtjet shpirtërore, fizike dhe morale.

### **Mendimet dhe idetë mbi viktimat dhe viktimologjinë**

Hans V. Hentingut, shkruante “ asnjë konstatim teorik nuk është aq shumë i rëndësishëm në luftë kundër krimit, sa njohja e saktë e viktimës. Më 1948 shkroi veprën “Krimi dhe viktima e tij”.Fred Exner, konstaton se te disa individ ekziston një lloj predispozicioni viktimologjik.Ernest Seelig, konstaton se viktima vetë shkakton rrethana të cilat kushtëzojnë paraqitjen e rastit kriminal. Vasile V. Stanciu, angazhohej në luftë kundër krimit të aplikohej solidariteti e jo individualizmi dhe egoizmi. Henri Ellenberger, ka trajtuar problemet viktimologjike dhe njohjen e rrethanave që shpijnë të viktimizimi, sidomos në mënyrë analitike vështron raportet psikologjike mes viktimës dhe viktimizuesit.

Ai parashtron problemin e relacioneve neurotike dhe psikologjiket kryesve dhe viktimave. Benjamin Mendelsohn, i pari angazhohet për themelimin e disiplinës së veçantë shkencore të viktimologjisë e cila do të studioj personalitetin e viktimës në tërësi dmth vetitë biologjike, psikologjike dhe sociale.

Ai viktimat i klasifikon në disa tipa:

- Viktima tërësisht e papërgjegjshme
- Viktimat më pak të përgjegjshme sesa kryerësi,
- Viktimat e përgjegjshme sa edhe kryesi,
- Viktimat e përgjegjshme më tepër se kryerësi,
- Viktimat plotësisht të përgjegjshme ose fajtore.

Gjithashtu i klasifikon edhe: viktimat e katastrofave natyrore, trafikut, aksidenteve në punë.

Emilio Viano, përmend nevojën e studimeve të: viktimave të sëmundjeve mentale, e personave të moshuar, e gjenocidit, depërtimeve me dhunë, e persekutimeve.

Andrew Karmen, është marrë me përcaktimin e vendit dhe statusin e viktimës në kuadër të drejtësisë penale, ma analizën e luftës për të drejtat e viktimës, kompensimin dhe rehabilitimin e viktimës etj. “WSV” shoqatë jofitimprurëse, joqeveritare e pranuar nga OKB dhe KE e cila në radhët e veta tubon shkencëtare, punëtorë social, kriminolog, avokatë, profesorë universiteti, studentë, njerëz nga praktika e të gjithë lëmenj. WSV ka kontribuar në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave për realizimin e kompensimit të viktimave dhe parandalimin e viktimizimit në tërë botën.

Çdo disiplinë shkencore, që synon të arrijë status të pavarur, përveç lëndës së vet, duhet t'i ketë edhe metodat të cilat i aplikon në hulumtimin dhe trajtimin e objekteve të studimit të vet.

Viktimologjia në trajtimin e formave dhe shkaqeve të viktimizimit përdor metoda dhe teknika të shkencave të mirënjohura, si: të sociologjisë, psikologjisë, pedagogjisë, kriminologjisë, kriminalistikës, mjekësisë forenzike. Metodat më të shpeshta janë: metoda e rasteve, observimit, klinike, anketës, bashkëbisedimit, analizës së lëndëve dhe dosjeve mbi viktimat, statistikore, numri i errët, vetakuzimit, viktimizimit etj.

Sipas kësaj metode, viktimat trajtohet duke vështuar vetitë dhe cilësitë e saj individuale, familjare, sociale dhe rrethanat e tjera, të vlefshme për vlerësimin e rastit konkret. Aplikimi kërkon punë ekipore, qasje interdisiplinare, mjete financiare sepse është mjaftë e shtrenjtë.

Esenca e aplikimit të saj qëndron në faktin se studiuesi dhe hulumtuesi analizon dhe trajton rastin konkret, vetitë dhe cilësitë e tij biopsikike dhe sociale, duke vrojtuar viktimën në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi.

Trajtimi i rasteve sipas kësaj metode kalon nëpër disa faza:

- Faza e ekzaminimit medicinal-psikologjik dhe social (ankesa sociale dhe ekzaminimi mjekësor)
- Faza e diagnozës viktimologjike (konstaton të dhënat, llojin dhe shkallën, masat emergjente, koston etj)
- Faza e veprimeve dhe masave që parashohin se në çfarë kohe dhe trajtimi duhet të ndërrohet gjendja e viktimës Faza e trajtimit për rehabilitimin e viktimave,
- Faza e nxjerrjes së konkluzave dhe propozimeve për nevoja teorike-shkencore empirike
- Metoda e anketës dhe e intervistës
- Janë hartuar dhe përsosur pyetësorë, teste dhe teknika të anketimit dhe intervistimit me të cilat mbledhen të dhëna lidhur me format, shkaqet dhe tipat e viktimave si dhe nevojat për mbrojtje dhe kompensim.

Me anë të teknikës së bashkëbisedimit përfitohen shumë të dhëna dhe informacione lidhur me rrethanat sociale dhe individuale të viktimizimit, e veçmas për shkallën e viktimizimit dhe nevojat e mbrojtjes nga viktimizimi sekondar. Bashkëbisedimi, si metodë teknike e mbledhjes së të dhënave zakonisht bëhet me viktimë të krimit, me familjare dhe të afërm të viktimave, me ekspertë.

Të gjitha analizat dhe trajtimet e lëndëve, dosjeve, procesverbaleve dhe dokumenteve mundësojnë nxjerrjen e përfundimeve të vlefshme mbi disa parametra më esenciale për format, shkaqet, mbrojtjen dhe kompensimin. Në studimet viktimologjike, posaçërisht përdoren metodat dhe teknikat statistikore (indeksi i viktimave, shkalla e numrit në 100 mijë banorë, mesatarja, përqindja dhe teknika të tjera statistikore, pastaj tregues tabelorë, trendet, diagramët etj.

Rastet e dukurisë së numrit të errët ndodhin te sjellje kriminale në ambiente familjare. Si shkaqe për moslajmërimin e rasteve janë mosbesimi në efikasitetin e organeve gjyqësore etj.

Përmes anketave, nga anketuesit kuptohen rastet krimeve të tyre të cilat nuk janë trajtuar në gjyqësi. Përmes anketave, nga anketuesit kuptohen rastet ku ata kanë qenë viktimë e që nuk janë trajtuar. Raporti i viktimologjisë me shkencat e tjera Viktimologjia dhe disiplinat e veçanta të viktimologjisë Klasifikimi në: viktimologji e përgjithshme, klinike, empirike, humane dhe juridike.

Viktimologjia e përgjithshme - Studion çështjet kryesore si: përkufizimin e nocioneve themelore, përkufizimin e kuptimit viktimë apo viktimizim, përkufizimin e lëndës, metodologjisë dhe metodave etj.

- Viktimologia klinike - Studion dhe trajton aspektin mjekësor-psikologjik të procesit të viktimizimit
- Viktimologjia empirike - Studion rrethanat dhe faktorët që kushtëzojnë viktimizimin.
- Viktimologjia humanitare - Studion dhe elaboron përkufizimin e kuptimit ndihmë apo mbështetje të viktimave, format dhe rregullat për realizimin e këtyre ndihmave.
- Viktimologjia juridike - studion të drejtat e viktimave, trajton normat nacionale dhe ndërkombëtare.
- Raporti i viktimologjisë me shkenca të tjera mbi krimin
- Mund të flitet për marrëdhëniet e viktimologjisë me shkencat kriminologjike dhe juridiko-penale, shkencat juridiko-civile, shkencat mjekësore, shkencat politike e sociale etj.
- Raporti me shkencat kriminologjike dhe juridiko-penale - viktimologjia si shkence e re, mbështetet në studimet dhe kërkimet juridiko-penale dhe kriminologjike.

Fenomenologjia e viktimologjisë paraqet një degë të veçantë, e cila merret me studimin e formave të paraqitjes së fenomenit të viktimizimit, në përgjithësi, dhe të viktimave të krimit në veçanti. Kjo fushë e viktimologjisë merret me studimin dhe përkufizimin e gjithanshëm të kuptimit të viktimës, me vëllimin dhe dinamikën, me shtrirjen dhe përhapjen, me tipat e viktimave, me komponentin e rrezikut viktimizues në shoqëri dhe me çështje të tjera të rëndësishme për fenomenin e viktimave.

Si viktima konsiderohen apo përkufizohen personat të cilët në mënyrë individuale / kolektive kanë pësuar dëm. Sipas deklaratës mbi parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit, viktima nënkuptohen ata që kanë pësuar lëndime fizike e mentale, pësime emocionale, humbje ekonomike etj.

Sipas rekomandimeve të komitetit të ministrave të KE-së, nr 8/2006 mbi mbrojtjen e viktimave të krimit dhe viktimave të akteve terroriste, viktima konsiderohen persona natyralë, anëtar i familjes apo personat e tjerë.

Vëllimi dhe dinamika e fenomenit të viktimizimit të viktimave – për praninë dhe shtrirjen e një fenomeni shoqëror, prezantohen disa tregues kuantitativë ose vëllimi i tij në hapësirë apo kohë.

- Moshë dhe gjinia – viktimat u përkasin grupmoshave të ndryshme .
- Statusi social – viktimat u përkasin të gjitha shtresave shoqërore.
- Shtrirja dhe përhapja e viktimave – është me rëndësi të njihen parametrat e shtrirjes rajonale dhe gjeografike.
- Klasifikimi dhe tipologjia e viktimave

- Kuptimi i klasifikimit apo tipologjisë së viktimave
- Kërkimet e ndryshme kanë treguar se mes viktimës dhe kryesve të shumë formave apo rasteve ekzistojnë relacione dhe raporte të ndryshme, qysh para rastit viktimizues.

Klasifikimi apo tipologjia e viktimave sipas Z.Shepareviq

- Viktima vullnetare - eutanazia, aborti, vetëvrasja, vetëfljimi për ideale apo qëllime të shenjta.
- Viktima e panjohur, edhe pse ka pësuar nuk paraqet rastin në polici (numri i errët)
- Viktima e pavëmendshme - kur nuk siguron derën e shtëpisë me qelës, nënçmojnë rrezikun etj.
- Viktima simuluese – viktima e shpifur, apo viktima e rrejshme.
- Viktima e mbetur në tentativë – ka planifikuar por nuk është bërë dot viktimë.

Klasifikimi apo tipologjia sipas H.V.Henting - viktimat sipas shkaqeve mund të ndahen në dy grupe:

1. Grupin që pësojnë për arsye të ndikimeve të faktorëve psiko-biologjikë (viktima e lindur)
2. Grupin që pësojnë më tepër për shkak të ndikimeve të faktorëve sekondarë të natyrës sociologjike.

Klasifikimi sipas Mendelsohn: bën dallimin në dy lloje të viktimave:

1. Në viktima të krimit (1-viktima tërësisht të pafajshme, 2-viktima më pak të fajshme, 3- viktima fajtore sa edhe kryesi, 4 viktima provokuese, 5- viktima e vetme fajtore).
2. Në viktima që bëhen si të tilla, për shkak të vetekspozimit.

Klasifikimi sipas E.A.Fattah – viktimat sipas kontributit i ndan në: 1- Viktima që nuk , 2-viktima abstrakte 3- viktima sprovuese ,4-viktima qe lut kryesit qe ta viktimizoj,5-viktima provokuese.

Klasifikimi sipas H.D.Schwind – duke komentuar tipologjinë e Hentingut, viktimat i klasifikon në këta tipa:

1-viktimat e situatës,

2-viktimat me raporte familjare,

3-viktima për shkak të profesionit apo mjeshtërisë,

4-viktima për shkak të lakmisë dhe përfitimit material, 5-viktima për shkak të përkatësisë sociale, 6-viktimat për shkak të gjendjes së veçantë biofizike dhe biopsikike.

Jean Pinatel thekson se viktima dhe kryesi paraqesin një “qift penal” i cili vështirë mund të ndahet në të gjitha raste që ndodhin në praktikë

Disa autorë konstatojnë se viktima dhe kryerësi, shpeshherë gjenden në marrëdhënie dhe raporte të ndryshme interaktive që më parë. Njohja e relacioneve ndërmjet tyre është me vlerë për mbrojtjen dhe zhdëmtimin apo kompensimin e viktimës.



Informacionet ndihmojnë që viktimat të mbrohet nga viktimizimi sekondar. Rreziku i viktimizimit apo faktor të riskut në literaturë emërtohen si një lloj predispozicioni viktimogjen (viktimë latente). Vetitë mund të jenë të lindura, biologjike, psikologjike, të fituara, sociale, familjare etj. Në literaturë si faktor apo rrethana biologjike përmenden viktimat fatale, të lindura, të sëmura, recidiviste, latente.

Disa autorë rrethana dhe faktor të rrezikut i dallojnë si rrethana personale (vetitë biopsikike, moshë, gjinia, inferioriteti fizik, invaliditeti, sëmurja psikike, alkooli, droga etj) dhe rrethana sociale (kushtet shoqërore, ekonomike, ideopolitike, familjare, adaptimit etj).

Format e viktimave në shoqërinë bashkëkohore 1- Viktimat e krimeve të dhunës kundër jetës,

Dhuna si veprim kriminal dhe si pasojë veçohet me disa tipare, si, p.sh: me veprim agresiv ndaj viktimës, me detyrim të viktimës që të veprojë kundër vullnetit të lirë, me atakim dhe rrezikim të jetës, të shëndetit, të lirisë dhe të mirave të tjera të viktimës. Dhuna manifestohet si dhunë fizike dhe si dhunë psikike, ajo mund të jetë e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë.

S.Frojd, dhuna paraqet një lloj zbrazje të individit nga tensionet dhe shqetësimet e brendshme të natyrës biopsikike.

Erih From, ekzistojnë dy lloje të manifestimit të dhunës:

- Veprimi agresiv defansiv i cili është i pranishëm si te njerëzit ashtu edhe te kafshët,
- Veprimi agresiv destruktiv, i cili është veçori vetëm te njeriu. Forma e tillë e dhunë fitohet dhe krijohet nga mënyra e formimit të individit gjatë jetës në ambientin e caktuar sociokulturor.

Erih thotë se dhuna është instinkt i brendshëm, ajo buron nga energjia instinktive për sigurimin dhe mbrojtjen e llojit dhe manifestohet në luftën për territor, luftën për partner seksual, luftën për dominim etj. Kjo dhunë në një farë mënyre edhe siguron një ekuilibër ekologjik në natyrë.

1- Viktimat e krimeve të vrasjes

Në shumë vende të botës numrin më të madh të viktimave e përbëjnë ato që janë pasojë e dhunës së krimeve të ndryshme, që atakojnë jetën dhe trupin e njeriut.

Krimi i vrasjeve dhe viktimat e tij më së miri janë zbardhur në kërkimet viktimologjike.

2- Raporti në mes viktimës dhe kryerësit të krimi i vrasjes

Viktima shpesh vetë e përshpejton, ndihmon, lehtëson kryerjen e vrasjeve dhe disa krime kundër jetës e trupit.

3- Motivet e viktimizimit të vrasjet

Vrasjet shpesh janë të nxitura nga sulmi dhe atakimi fizik i vetë viktimës ndaj kryerësit. Viktimizimi i personave të vrasjet ndikojnë motivet dhe shtytjet që lidhen me mënjanimin e pengesave për realizimin e

planit dhe synimit të kryerësve apo viktimës për arritjen e përfitimeve materiale: lakmia materiale, grabitja e pasurisë, trashëgimia, eliminimi i pretendentëve dhe rivalëve në trashëgimi, biznes, tregti etj.

- 4- Moshë e viktimave të vrasjeve – është 20 deri 45 vjeç.
- 5- Gjinia e viktimave të vrasjes – më tepër të gjinisë mashkullore.
- 6- Viktimat e dhunës sipas disa zakoneve dhe normave tradicionale

Njihet prerja e klitorisit “klitoridektomia të organit gjeneral të femrës, “infibulacioni “ apo amputimi dhe qepja e buzëve të jashtme apo të brendshme të vagjinës. Në Indi gruaja digjet në furrë të druve pas vdekjes së burrit. Në Kinë fëmijët vajza detyrohen ti mbajnë këpucët e drurit me qëllim të pengimit të zhvillimit të tyre.

- 7- Viktimat e hakmarrjes dhe gjakmarrjes
  - Komiteti i pajtimit mbarëkombëtarë që vepron në Shkodër përveç pajtimit të familjeve të hasmuara publikon raporte dhe revistë të vetë të pavarur.
  - Viktimat e dhunës në familje Përkufizimi i dhunës në familje
  - Viktimat e dhunës që ushtrohen ndaj familjes, brenda familjes ose jashtë familjes.
  - Femra-gruaja, si viktimë e dhunës në familje

Buchat, dhunën në familje e përkufizon si atakim të integriteti trupor dhe mental ndaj një personi në kuadër të një raporti familjar, duke përdorur forcën apo dhunën fizike dhe psikike nga personi më i fuqishëm fizikisht.

Në viktimizimin e femrës ndikojnë vetitë dhe struktura e saj anatomiko-biologjike. Menstruacioni, shtatzënia dhe menopauza ndikojnë fuqishëm në pozitën dhe relacionet e saj me rrethin dhe në familje, në shoqëri, në raporte të ndryshme me persona të tjerë. Këto rrethana shpesh janë faktorë vendimtarë të viktimizimit të saj.

Feministja, Helen Dojq në studimet e veta mbi psikikën e femrave, viktimizimin e tyre e konstaton si ndikim esencial ka gjendja inferiore apo pasive dhe mazohizmi i tyre. Gjendja pasive dhe inferiore e ka bazën e vet në funksionet e qelizave seksuale dhe në anatominë e organeve seksuale.

Fëmijët adoleshentë jepen edhe pas dukurive abuzues, si: shoqërimi me individë dhe grupe të adoleshentëve problematikë edhe abuzivë, me konsumim të duhanit, alkoolit, me konsumim të substancave narkotike etj.

Veprimet më të shpeshta të viktimizimit janë braktisjet e fëmijëve. Forma të ushtrimit të dhunës janë rrahjet, keqtrajtimit fizike, lëndimet trupore, mosushqimi i rregullt.

Hulumtimet i ndajnë disa grupmosha; prej lindjes deri-3, 4-7, 8-12, 13-15, 16-18.

- Statusi familjar i fëmijëve të viktimizuar
- Faktorët apo shkaqet e viktimizimit – Etiologjia Viktimologjike

Etiologjia viktimologjike bazohet në trajtime të etiologjisë kriminale. Shkaqet e viktimitetit apo viktimizimit duhen kërkuar në komponentë, veti dhe rrethana biopsikike apo socialkulturore të viktimës dhe ambientit të saj. Faktorët e jashtëm të viktimizimit

Faktorët ekonomiko-socialë

Skamja apo varfëria, papunësia dhe krizat ekonomike, krizat e banimit, migrimi dhe lëvizja e popullsisë, diskriminimi i të huajve, korrupsioni, mashtrimi i konsumatorëve etj. Si faktorë që drejtpërdrejtë ndikojnë në viktimizim.

Faktorët politikë dhe konfliktet politike

Faktorët e natyrës politike, si konflikte politike, luftërat, përndjekjet politike, abuzimi i pushtetit në dëm të qytetarit, diskriminimet në baza etnike, fetare, raciale, gjinore apo politike.

Masmediat e shkruara dhe elektronike si faktorë të viktimizimit

Kërkimet empirike dëshmojnë se mediet e shkruara dhe ato elektronike janë faktorë të fuqishëm, si në paraqitjen ashtu edhe në parandalimin e viktimizimit të njerëzve.

Familja dhe rrethanat familjare si faktorë të viktimizimit

Kriza e madhe që ka përfshirë familjen, shkollën dhe mjedisin social, ka shtuar edhe faktorët e rrezikut për viktimizim. Në këto raste shpesh fëmijët janë viktima “Memece”, viktima që nuk flasin, për shkak të ligjit të “heshtjes” që atyre u imponohet në ambientin familjar.

Disa sëmundje sociale si faktorë të viktimizimit

Viktimat e perversioneve në praktikë, shpesh janë të lidhura me ndikimin e narkotikëve apo pijeve të ndryshme alkoolike.

Faktorët e brendshëm ose subjektivë të viktimizimit

- Vetitë dhe cilësitë biofizike
- Faktorët subjektivë/individualë mund të kenë bazën në ndikime të natyrës biologjike dhe psikike

Sipas shpjegimeve biologjike, viktimizimi i personave ndodh për shkak të vetive dhe cilësive të natyrës anatomike dhe biologjike.

Disa autorë theksojnë se çrregullimet kromozomike, devijimet në formulën e kromozomeve, çrregullime dh probleme në sistemin e gjëndrave me tajitje të brendshme ndikojnë që disa njerëz të viktimizohen më shumë se të tjerët.

Vetitë psikike dhe viktimizimi

Këto probleme dhe devijime rëndom kanë të bëjnë me karakterin, temperamentin, inteligjencën, emocionet, motivet, shprehitë etj.

Karakterin dhe temperamentin si faktorë të viktimizimit

Shpesh pësojnë individë me karakter labil, persona të pavendosur, frikacakë, por edhe ata që janë tepër të guximshëm dhe altruistë. Disa janë të prirur që, duke dashur t'i kënaqin dëshirat, epshet e veta, lakminë dhe egoizmin, të bien pre e vetive të tilla, Disa të tjerë vetëflijohen duke u futur në rreziqe të ndryshme për të afërmit apo për interesa të ndryshme patriotike, politike, shkencore, humane etj.

Tipat e temperamentit Kolerik dhe Sanguinik shpesh pësojnë për shkak zemërimeve, frikës së madhe, streseve, emocioneve që vijnë apo nxiten nga rrethi i jashtëm.

Inteligjenca si faktor i viktimizimit

Mendohet se viktimat në pjesën dërrmuese janë persona me inteligjencë të ulët ose afër mesatares.

Individët me inteligjencë të lartë, shpesh janë cak i atakimeve dhe sulmeve të kriminelëve apo grupeve të krimit të organizuar, sepse ata konsiderohen si pengesë për realizimin e qëllimeve të tyre kriminale.

Emocionet si faktorë të viktimizimit

Emocionet janë veti suptile e personalitetit, që manifestohen si përjetime të gjendjeve të caktuara shpirtërore të tij, që ndryshe quhen : afekt, brengosje, dashuri, dhembje, frikë, gëzim, hidhërim, urrejtje, indinjatë, kënaqësi, lemeri, tmerr, neveri, rënkim, shpresë, dëshpërim, zemërim etj.

Personat me gjendje jostabile emocionale, siç dihet , shpesh kryejnë veprime delikuede dhe kriminale.

Motivet si faktorë viktimizues

Njeriu, për sjelljet dhe veprimet e veta, është i shtyrë nga disa nxitje, nevoja dhe dëshira të brendshme. Ato nxitje, dëshira dhe nevoja të brendshme quhen motive.Motivet përbëhen prej elementeve të vetëdijes dhe të vullnetit. Plotësimin e nevojave, dëshirave dhe kërkesave të tjera të brendshme njeriu e bën në koordinim të plotë mes këtyre dy komponentëve; të vetëdijshmes dhe evolutive. Motivet qofshin të lindura, qofshin të fituara, mund të paraqiten si faktorë të viktimizimit dhe të pësimit të njerëzve. Lakmia dhe pangopësia materiale këta persona i fusin veprime kriminale, nga të cilat shpesh edhe vetë viktimizohen.

## Çrregullimet mendore si faktorë viktimizimi

Këto sëmundje mund të jetë të lehta, si neuroza, të mesme, si psikopati dhe të rënda si psikoza. Në literaturë këto viktima emërohen si viktima depressive, hipodondrike, fobike, hysterike etj. Ata fantazojnë se janë cak ti sulmeve të imagjinueshme. Në këtë drejtim manifestojnë një mosdurim dhe xhelozitë patologjike dhe kjo i shtyn ata që të bëhen agresivë.

Tipat psikopatë historikë (histrionikë) përpiqen të jenë në qendër të vëmendjes, nëse jo inatosen dhe zemërohen. Personat me çrregullime narcisoide apo narcistike, janë tipa të cilët e mbivlerësojnë veten, janë të dashuruar në aftësitë dhe pamjen e tyre. Çrregullimet e rënda psikike konsiderohen sëmundjet e skizofrenisë, epilepsisë etj.

Të drejtat e viktimave dhe trajtimi i tyre

Mendimet dhe qasjet e para për të drejtat e viktimave

Të drejtat e njeriut janë pjesë integrale e të drejtave të njeriut, por që nuk janë të respektuara sa duhet. Angazhimet dhe përpjekjet e asociacioneve dhe organizatave ndërkombëtare për rregullimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave

1- Iniciativat e agjencive dhe organizatave të specializuara të OKB

2- Iniciativat dhe propozimet e shoqatës botërore të viktimologjisë (WAV)

Iniciativat dhe propozimet e asociacioneve të KB-së –Seminari i Helsinkit

Viktimës duhet t'i sigurohet konfidencialiteti i plotë në të gjitha fazat e procedurës, po ashtu duhet t'i garantohet ruajtja e intimitetit dhe mospublikimi i rrethanave komprometuese që edhe e riviktimizojnë atë.

E drejta e viktimës në lëvizje të lirë dhe mbrojtje nga bezdisjet dhe kërcënimet

Kryerësve dhe viktimizuesve u ndalohej kontakti fizik, kontakti me telefon, qasja në hapësirë, lokale, vendbanim, shtëpi, vende të punës apo territor në distanca dhe parametra të caktuar.

Fenomenet e bezdisjes ose fenomenet “stalking” rëndom manifestohen me bezdisje duke thirrur në telefon, duke ia zënë pritën, duke shkruar letra, duke bërë gjeste të llojllojshme provokuese dhe forma të ngjashme të shqetësimit.

Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje sipas Reg. UNMIK 2003/12

Rregullorja përveç që ka përcaktuar nocionet themelore të dhunës në familje, ajo në disa dispozita ka rregulluar edhe masat për mbrojtjen nga dhuna në familje, si:

1- Urdhëresa për mbrojtje ( masa shqiptohet për arsye dhe në raste të numëruara konkretisht)

2- Urdhëresa për mbrojtje emergjente (me qëllim të mbrojtjes emergjente të drejtave dhe lirive të viktimës) 3- Urdhëresa për mbrojtje të përkohshme emergjente (kur gjykatat nuk janë në gjendje të reagojnë).

Mbështetja dhe përkrahja e viktimave – informimi i viktimave

Mënyrat dhe mekanizmat më të njohur për mbështetjen e viktimave të krimit, të parapara me ligje pozitive dhe norma ndërkombëtare, janë: Informimi i viktimës lidhur me procedurën gjyqësore dhe roli i saj në trajtimin e rastit viktimizues. Njohja me mjetet që ajo i ka në dispozicion për të shprehur dhe për të realizuar të drejtat dhe interesat e veta si viktimë. Ofrimi i ndihmës viktimës në të gjitha fazat e trajnimit të çështjes së saj. Masat për garantimin e sigurisë dhe të mbrojtjes së jetës së viktimës, të afërmeve të saj apo dëshmitarëve që dëshmojnë në favor të saj etj.

Në shumë vende publikohen dhe shpërndahen: doracakë, udhëzues, broshura e materiale të botuara.

Ndihma e parë, strehimi dhe ushqimi i viktimave

Përkrahja dhe mbështetja e viktimave duhet të fillojë qysh gjatë ngjarjes viktimizuese, duke i ofruar asaj ndihmën e parë shëndetësore dhe ligjore. Rreth kujdesit mjekësor, rreth strehimit, ushqimit, veshmbathjes, vënies së kontakteve me familje apo të afërm, shoqërimit, ofrimit të mbrojtjes dhe sigurimit të tyre nga kërcënimet dhe shantazhet, ofrimit të masave siguruese, vënien nën mbikëqyrje dhe kujdes të policëve ose shërbimeve të tjera.

Për viktimat e dhunës ndaj grave, ndaj femrave apo vajzave të trafikuar në RMV janë themeluar tri strehimore:

- 1- Strehimorja për qëndrim afatshkurtër (në Prishtinë)
- 2- Strehimorja për qëndrim më të gjatë (deri në 6 muaj, në Gjakovë)
- 3- Strehimorja për qëndrim dhe siguri deri në riatdhesim

Mbështetja dhe siguria fizike e viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj

Nëse viktimat binden se çështjet e tyre nuk përfillen atëherë ato vetë do të marrin në dorë ligjin dhe të zbatojnë vetëgjyqësinë.

Kompensimi dhe zhdëmtimi i viktimave të krimit

Kuptimi i kompensimit – zhdëmtimit

Kompensimi duhet të përfshijë kthimin e pasurisë apo shpërblimin në të holla për dëmin e pësuar apo fitimin e humbur, shpagimin e shpenzimeve të shkaktuara lidhur me viktimizimin, shpenzimet e shkaktuara lidhur me shërbimet e ofruara për sanimin e gjendjes shëndetësore, dëmeve fizike, psikike,

dëmeve morale, pra të gjitha dëmeve dhe shpenzimeve lidhur me rivendosjen e të drejtave të atakuara. Dëmi duhet të kompensohet nga kryerësi e nëse kjo nuk është e mundur atëherë duhet të bëhet nga shteti.

Në zhdëmtim të viktimës llogariten edhe shpenzimet për barna, për proteza, shpenzimet mortore, shpenzimet për anëtarë të rrezikuar të familjes dhe shpenzime të tjera

Format e kompensimit apo zhdëmtimit të viktimave

Lidhur me realizimin e dëmshpërblimit apo zhdëmtimit, në botë sot përmendën tri forma, si, psh:

Modeli francez shkon nëpërmjet padisë në procedurën penale, në kuadër të trajtimit të përgjegjësisë së kryerësit për veprën penale dhe për dëmin e shkaktuar viktimës, i njohur si procedurë adezive, ku i dëmtuari në procedurë penale e shtron kërkesën për kompensim.

Modeli i probacionit si parakusht për t'u zbutur dënimi është që ai më parë të kompensojë apo zhdëmtojë viktimën.

Modeli anglez i kompensimit Viktimizuesi me urdhër pagesë duhet të obligohet që të bëjë pagesë të dëmshpërblimit në formë të kompensimit që i paguhet shtetit, por ai pastaj e refundon në llogari të viktimës.

Kërkesa pronëso- juridike mund të përfshijë tri aspekte:

1- Zhdëmtimin apo kompensimin e dëmit, 2-Kthimin e gjësendit, 3-Anulimin e ndonjë veprimi juridik.

Kur është fjala për padinë civile lidhur me zhdëmtimin apo kompensimin e dëmit në procedurën kontestimore viktimë përpos kërkesës formale duhet të sigurojë të gjitha provat në të cilat i mbështet kërkesat e veta konkrete, poashtu vet duhet të kujdeset për ecurinë e procedurës, për afatet e veprimeve të ndryshme gjatë zgjatjes së procedurës. Viktimë duhet t'i bartë vetë shpenzimet e procedurës.

Problemet lidhur me kriteret e kompensimit apo zhdëmtimit të viktimave

Rreth zhdëmtimit të viktimave të krimit, sidomos për disa lloje të veprave penale, sot janë aprovuar norma dhe standarde tanimë të njohura. Agjensitë e sigurimeve të njerëzve, sigurimeve të jetës, sigurimeve të pasurisë (shtëpisë, lokaleve, automjeteve), kanë hartuar kriteret dhe rregulla mjaft konkrete që në masë të madhe u ndihmojnë viktimave. Mirëpo, ende ka probleme në zbatimin e disa kriterëve për kompensimin e frikës, stresit, traumave, cënimit të nderit cënimit të autoritetit, shkaktimin e fyerjes, shkaktimin e turpit, cënimin e intimitetit seksual, zbulimin e fshehtësisë familjare apo personale etj.

Kur nga kryerësi apo nga pasuria e tij nuk mund të arrihet kompensimi, këtë detyrim e merr shteti. Në rastet kur viktimat kanë ndonjë formë të sigurimit, si, p.sh., sigurimi i jetës, sigurimi i pronës, sigurimi i automjetit, sigurimi shëndetësor dhe sigurime të tjera, ato rëndom këto i realizojnë varësisht nga lloji i krimit dhe dëmit të shkaktuar nga polisa e sigurimeve të firmave apo institucioneve siguruese, në bazë të kontratave të sigurimit apo në bazë të vendimit gjyqësor. Mirëpo, çështjet komplikohen kur sigurime të tilla viktimat nuk kanë.

#### Kompensimi i viktimave nga shteti

Në raste të kompensimit shtetëror, zakonisht vlera e zhdëmtimit është e kufizuar dhe ajo shpesh nuk përfshin kërkesa të arsyeshme të pësimeve që viktimat i ka përjetuar, si p.sh., dëmin moral dhe kompensimin për vuajtjet shpirtërore.

#### Kompensimi i viktimave nga fondet e veçanta

Në disa vende janë paraparë edhe zgjidhje të tjera si detyrimi i kryerësit të krimit që gjatë vuajtjes së dënimit të paguajë një sasi të parave të grumbulluara në fond të veçantë “Fondi për kompensimin e viktimave të krimit”. Kompensimi i viktimave nga OJQ organizatat humanitare dhe shoqatat bamirëse

Po ashtu, në vende të caktuara grumbullohen mjete nga donacione dhe shoqata bamirëse dhe burime të tjera të cilat destinohen për mbrojtjen dhe zhdëmtimin e viktimave.

- Masat për parandalimin e viktimizimit
- Masat ekonomiko-sociale
- Dallimet e mëdha mes të varfërve dhe të pasurve, diskriminimi në baza etnike, fetare, politike, raciale dhe rajonale, kanë nxitur një valë të madhe të pakënaqësive, mostolerancës dhe dukurive të tjera, të cilat drejtpërsëdrejti apo tërthorazi po kontribuojnë në viktimizimin e njeriut në të gjitha vendet e botës. Prandaj, parakusht i parandalimit të viktimizimit është zgjidhja e këtyre problemeve, duke ofruar perspektivë për të gjithë.
- Masat për aftësim & rritjen e efikasitetit të organeve shtetërore në mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të viktimave

Komiteti i ministrave të këshillit të Evropës, 14 Qershor’06 ka paraparë dhe rekomanduar një numër të caktuar të masave parandaluese lidhur me mbrojtjen e viktimave të akteve terroriste dhe viktimave të krimit transnacional si dhe pengimin e viktimizimit në rrethana të tilla. Andaj , për të parandaluar viktimitetin në shoqëri, është e nevojshme që organet dhe institucionet shtetërore të aftësohen vetë, si në rrafshin organizativ dhe profesional.



Brenda policisë duhet të formohen shërbime të veçanta, të cilat duhet të merren me trajtimin e viktimave (qasje humane, bashkëndjnjë vuajtjen etj)

Organet e prokurorisë, të gjykatave dhe organet e tjera shtetërore, që merren me rastet viktimizuese gjithashtu duhet të sillën me përkushtim dhe përgjegjësi lidhur me të drejtat dhe kërkesat e viktimave për mbrojtje, mbështetje dhe për kompensim apo dëmshpërblim.

Masat e agjencive dhe organizatave të ndryshme publike dhe joqeveritare

Me qëllim të parandalimit të viktimizimit dhe mbrojtjes së viktimave, është me rëndësi të madhe që të themelohen, të funksionojnë edhe agjenci, organizata, shoqata publike dhe joqeveritare.

Masat për informimin e drejtë të viktimave

Në arritjen e rezultateve më të mira, si parakusht themelor është informimi i drejtë, për këtë arsye botohen publikime, materiale informative, doracakë dhe format të tjera të ofrimit të informacioneve për viktimat.

Masat lidhur me vetëdijesimin dhe edukimin mbi mbrojtjen dhe kompensimin e viktimave

Viktimat para rastit viktimizues fare pak kanë ditur për rrethanat që shpijnë drejt viktimizimit. Në këtë drejtim lypset të hartohen programe dhe projekte të veçanta për ofrimin e informatave, por edhe vlerësime reale për shkallën e vëllimin dhe format e viktimizimit, për faktorët e rrezikut që çojnë në viktimizim, për të drejtat dhe format e mbështetjes së viktimave dhe çështjeve të tjera.

Rol të madhe luajnë edhe mediat e shkruara dhe elektronike, andaj shoqatat dhe organet shtetërore duhet t'iu ofrojnë mediave të gjitha materialet lidhur me fenomenologjinë dhe etiologjinë e viktimizimit .

Masat për ndryshimet dhe amonizimet e legjislacionit pozitiv lidhur me mbrojtjen, të drejtat dhe kompensimin e viktimave. Vendet që pretendojnë të aderojnë në organizata dhe asociacione të tjera ndërkombëtare, patjetër duhet që rregullativën e tyre ligjore penale, civile, administrative ta harmonizojnë dhe ta përshtatin konform atyre dokumenteve. Në RMV menjëherë pas formimit të shteti duhet të nxirren ligje mbi mbrojtjen e viktimave të dhunë në familje, mbi mbrojtjen e viktimave të trafikimit të femrave dhe fëmijëve, mbi mbrojtjen e viktimave të luftës, viktimave të akteve terroriste dhe krimin të organizuar, mbi mbrojtjen e viktimave të krimeve kundër jetës dhe trupit, viktimave të sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme, si AIDS etj.

Masat për bashkëpunim dhe koordinim vendor dhe ndërkombëtar në mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e viktimizimit.

Me qëllim të parandalimit të viktimizimit, patjetër nevojitet një koordinim i planifikuar mirë mes organeve shtetërore e të drejtësisë dhe organizatave e agjencive të ndryshme që merren me problematikën e mbrojtjes së të drejtave të viktimave.

Me drejtësi restorative nënkuptojmë dëmshpërblimin me pajtimi e kryerësit dhe viktimës me anë të ndërmjetësimit me qëllim të realizimit të kompensimit adekuat dhe krijimit të një gjendje relaksuese midis tyre. Në këto negociata duhet të inkuadrohen viktimat, kryerësi dhe prokurori. Mediatori apo ndërmjetësuesi duhet të jetë njeri me vullnet dhe durim të madh.

Rekomandimi nr.19/99 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për ndërmjetësim në çështjet penale.

Komiteti ka nxjerrë këtë rekomandim me dt.: 15 Shtator 1999. Kështu në

Neni 1. Parimet themelore në të cilat duhet të mbështetet ndërmjetësimi apo mediacioni, neni 2. Baza juridike e ndërmjetësimit,

Neni 3. Funkcionaliteti i drejtësisë penale lidhur me ndërmjetësimi, neni 4. Funksionimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, neni

Neni 5. Realizimi i ndërmjetësimit.

Një vështrim historik i ndërmjetësimit dhe pajtimit në mes kryerësit dhe viktimës

Bazë mbështetëse e të gjitha ndërmjetësimeve ka qenë caktimi i kompensimit adekuat për palën e dëmtuar pra për viktimën.

Drejtësia restorative në masë të madhe tenton që deri diku t'i zbusë efektet jo favorizuese të drejtësisë retributive dhe resocializuese me filozofinë e ndërmjetësimit dhe restauracionit të gjendjes midis kryerësit e viktimës, duke kompensuar dëmin e shkaktuar.

Fazat e zbatimit të drejtësisë së ndërmjetësimit apo restorative

Aktivitet në realizimin e drejtësisë restorative apo ndërmjetësimi, me qëllim të pajtimit me dëmshpërblimit, kalojnë nëpër tri faza kryesore: 1- Faza para ndërmjetësimit, 2-Faza e ndërmjetësimit, 3-Faza e përcjelljes

Faza para ndërmjetësimit

Faza paraprake është e shoqëruar me një varg veprimesh serioze dhe ka të bëjë me:

- Vënien e kontaktit të parë me palë,
- Marrjen e pëlqimit të tyre për angazhim,
- Paraqitjen e provave të mundshme
- Caktimin e bisedave,

- Caktimin e agjendës së kontakteve dhe bisedave,
- Caktimin e kohës dhe vendit të mbajtjes së kontakteve,
- Caktimin e personit për ndërmjetësim – mediatorit.

#### Faza e ndërmjetësimit

Ndërmjetësuesi së pari analizon rastin viktimizues, veprën penale dhe pasojat e saj. Pastaj e propozon një program për ndërmjetësim, të cilin ua prezanton veç e veç viktimës dhe kryerësit.

Tek kryerësit u ofrohet mundësia që të prezantojnë edhe anën pozitive të personalitetit të tyre dhe tek ata aktivizohet edhe ndjenja e brejtjes së ndërgjegjes për krimin e kryer.

#### Faza e përcjelljes dhe zbatimit të marrëveshjes për pajtim dhe kompensim

Ndërmjetësuesi duhet të përcjellë realizimin e pajtimit, zbatimin e kushteve parimore, por edhe atyre veç e veç për mënyrat dhe modalitetet e zbatimit të marrëveshjes për kompensim.

#### Parimet bazë të drejtësisë së ndërmjetësimit apo restorative

Parimet kryesore në të cilën mbështetet drejtësia e ndërmjetësimit dhe pajtimit me dëmshpërblim, janë:

- 1-Vepra penale konsiderohet si konflikt midis njerëzve, e jo vetëm shkelje e ligjit
- 2- Ndaj krimit reagohe në mënyrë sanuese, e jo me hakmarrjen dhe revansh
- 3- Aktiviteti i ndërmjetësimit drejtohet në dobi edhe të viktimës, edhe të kryerësit me një ndjeshmëri dhe synim që plaga të shërohet.
- 4- Ndiurma dhe aftësimi i viktimës dhe kryerësit që ata vetë në mënyrë të barabartë t'i zgjidhin problemet që kanë ndodhur mes tyre.

#### Vështrim kritik i drejtësisë së ndërmjetësimit apo restorative

Programin e pajtimit e cilësojnë edhe disa dobësi dhe vërejtje kritike, Si vërejtje përmendet fakti se pajtimi i viktimës dhe kryerësit nuk është përherë ekuivalent me dënimin me burgim.

Programi i pajtimit më shumë është marrë me kompensimin e dëmit sesa me pajtim të viktimës dhe kryerësit. Ndërmjetësimi sipas Kodit të Procedurës Penale të RMV-së Sipas nenit 228, prokurori publik mund të dërgojë një kallëzim penal në ndërmjetësimin për veprat penale të dhunshme me gjobë ose me burg deri në tre vjet.

Marrëveshja mund të arrihet vetëm përmes ndërmjetësimit me pëlqimin e të pandehurit dhe të dëmtuarit. Afati për arritjen e marrëveshjes nuk mund të kalojë tre muaj. Me rastin e arritjes së ndërmjetësimit prokurori publik e hedh kallëzimin penal.

## Referencat

1. Adler, Freda dhe të tjerë: Criminology, New York, 1995, fq. 397.
2. Bassiouni, M. Cherif [ed.] (1988); International Protection of Victims; Paris, Association Internationale De Droit, érès.
3. Bassiouni, M.C., (2006), "International Recognition of Victims' Rights", Human Rights Law Review 6: 2.
4. Doc.dr.sc. Nedžad Korajlić, "Deliktet e gjakut, sekeuale, pasurore" Sarajev/Prishtinë, 2007, fq.34
5. Elezi, Ismet. 2014. E drejta penale: Pjesa e posaçme. Botimet Kumi. Tiranë.
6. Elezi, Ismet. 2014. E drejta penale: Pjesa e posaçme. Botimet Kumi. Tiranë. Capie, D. (2011). Small arms, violence and gender in Papua New Guinea: Towards a research agenda. Asia Pacific Viewpoint, 52(1), fq. 42-55.
7. <sup>1</sup>Gjenerali Trifunović: Nuk do të shkoj në gjykim", faqja e internetit Radio Evropa e Lirë, 14 korrik i vitit 2010. [http://www.slobodnaevropa.org/content/general\\_trifunovic\\_optuzen\\_za\\_ratni\\_zlocin\\_u\\_sloveniji/2099828.html](http://www.slobodnaevropa.org/content/general_trifunovic_optuzen_za_ratni_zlocin_u_sloveniji/2099828.html).
8. Greer, C. (2013) 'Crime and media: understanding the connections', in C. Hale, K. Hayward, A. Wahidin and E. Wincup (eds), Criminology (3rd edn). London: Oxford University Press. fq.143–63
9. Hallevey, Gabriel, (2010), A Modern Treatise on the Principle of Legality in Criminal Law, Springer.
10. Henting, Hans Von: The criminal and his victim, Archon Books, 1967, fq. 383.
11. Horst Entorf, Economic Factors of Victimization: Evidence from Germany, First published: 20 May 2015 <https://doi.org/10.1111/geer.12075>
12. Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, neni 8: [http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf)
13. Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec (2006) 8 Komiteti i ministrave të vendeve anëtare për ndihmë të viktimave të krim
14. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 139/2008, në dispozicion në: [http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/default\\_mak.asp](http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/default_mak.asp)

15. Komiteti CAT, Komenti i përgjithshëm Nr. 3:  
[https://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/gc/cat-c-gc-3\\_en.pdf](https://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/gc/cat-c-gc-3_en.pdf)
16. Konventa për mbrojtjen e personave lidhur me përpunimin automatik të dhënave personale, 108/GDPR, neni 9: <https://rm.coe.int/1680078b37>
17. Lak, R. et al. (1992). Final report on domestic violence. Report No.14. PNG Law Reform Commission: Boroko
18. Maguire, M. (2012) 'Criminal statistics and the construction of crime', in M. Maguire, R. Morgan and R. Reiner (eds), *The Oxford Handbook of Criminology* (5th edn). Oxford: Clarendon Press.
19. Minskaya, V. S., & Chechel, G. I. (1988). *Victimization factors and the mechanism of criminal behavior*. Irkutsk: Irkut University Press.
20. Polubinsky, V. I. (1979). *Legal basis of the doctrine of crime victim*. Gorky.
21. Pr. Dr. Ragip Halili "Viktimologjia" 2007, fq.63
22. R (Press Association) kundër Cambridge Crown Court [2012] EWCA Crim 2434, [2013] 1 WLR 1979, paragrafët 15-17
23. Rabije Dervishi, *Viktimat e abuzimit me alkool dhe substancat narkotike*, Tetove, 2016
24. Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 nga Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas (1992) si dhe Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj grave (1993): <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm>
25. Udhëzues për mbrojtjen e viktimave-Si të punohet me viktimat e krimit, OSCE, Misioni në RMV, Prishtinë, 2001, fq. 44 (më tutje i referohemi si Udhëzuesi).
26. UNODC (2016). *Global Report on Trafficking in Persons 2016*, p. 7, 28
27. *Victimhood, Identity, and Agency in the Early Phase of the Troubles in the Northern Ireland*, Sissel Rosland, *Identities*, 16:3, 294-320,
28. *Victimology in transitional justice: Victimhood, innocence and hierarchy*, Kieran McEvoy Queens University Belfast, UK; Kirsten McConnachie, University of Edinburgh, UK, *European Journal of Criminology* 9(5) 527-538, 2012.
29. *Victimology in transitional justice: Victimhood, innocence and hierarchy*, Kieran McEvoy Queens University Belfast, UK; Kirsten McConnachie, University of Edinburgh, UK, *European Journal of Criminology* 9(5) 527-538, 2012.

30. ЗАКОН ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА Службен весник на РМ, бр. 150 од 18.11.2010  
година